**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec*

---

**01 Nr. 05/24**
**Rahovec, 21.5.2024**

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal që të marrin pjesë në mbledhjen e pestë (5), e cila do të mbahet më: **30 maj 2024 (enjte),** me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje, propozoj këtë:

## R E N D  D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit për shpalljen "QYTETAR NDERI" të Komunës së Rahovecit, z. Pandeli Majko, ish-kryeministër i Republikës së Shqipërisë;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për themelimin e Shtëpisë-muze të dy heronjve të Kosovës, Bedrush dhe Fehim Gashit;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, personave fizikë dhe juridikë nga 1 (një), deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, P- 01039-0, ZK- Xërxë;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe për vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P- P- 01039-0, ZK-Xërxë;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për konstituimin e të drejtës së servitutit sendor (të drejtës së kalimit) në parcelat publike P-71510057-02680-1 dhe P-71510057-02680-2 – ZK Rahovec;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për konstituimin e të drejtës së servitutit sendor (të drejtës së kalimit) në parcelen publike kadastrale, sipas certifikatës së pronësisë P-71510032-00069-0 në ZK- Zoqishtë;
8. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve.

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Arbër Zenuni**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly of Rahovec*

# PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.4.2024,** me fillim në orën **10:20.** Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Arbër Zenuni**. Në fillim, kryesuesi konstatoi se kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 31 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 27.

**Kryesuesi:** Përshëndetje për të gjithë! I nderuari kryetar i Komunës, **z. Smajl Latifi**, nënkryetar, **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit. Për këtë mbledhje të **katërt** të vitit 2024, së bashku me kryetarin, kemi vendosur për këtë rend dite:

## REND DITE

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizikë dhe juridikë, P- 71510057-01643-1, zk - Rahovec;**
3. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-71510057-01643-1, zk - Rahovec;**
4. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës – hapësirën e objektit të QKMF-së për shfrytëzim Ministrisë së Shëndetësisë;**
5. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës, P-01469-4, zk – Rahovec;**
6. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizikë dhe juridikë, P- 71510069-01505-0, zk - Retijë;**
7. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;**
8. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/ eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare (IEAAP);**
9. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Arsim të Komunës e Rahovecit;**
10. **Shqyrtimi i Raportit Financiar, janar – mars 2024;**
11. **Shqyrtimi i informatës mbi implementimin e projektit të mirëmbajtjes dimërore dhe verore të rrugëve në Komunën e Rahovecit;**
12. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e Muzeut të Masakrës në Krushë të Madhe;**
13. **Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve.**

**Kryesuesi:** Atëherë, përshëndetje për të gjithë! A ka dikush diçka apo ndonjë propozim shtesë?...
**Defrim Kafexhiu:** Faleminderit, kryesues! I nderuari kryetar, nënkryetar, anëtarë të kuvendit, drejtorë të drejtorive, medie, të pranishëm! Në emër të grupit të LVV-së propozoj që tashmë pikën e fundit të rendit të ditës (pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve) ta rikthejmë si pikë të dytë të rendit të ditës. Për shkak të harmonisë që e kemi pasur si kuvend dhe mendoj që është të jetë ashtu siç ka qenë më herët. Nuk besoj që ka qenë vendim i drejtë ky propozim i grupit të Aleancës dhe ju kërkoj që të tërhiqeni pas dhe të vendoset përsëri pika në fjalë, si pikë e dytë e rendit të ditës.
**Lirigzon Kastrati:** Faleminderit, kryesues! I nderuar ekzekutiv, të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës, përfaqësues të KFOR-it. Gjithashtu, edhe unë në emër të grupit të LDK-së, mbështes propozimin paraprak të Defrim Kafexhiut, që pika e fundit e rendi të ditës (pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve), ta rikthejmë si pikë të dytë të rendit të ditës. Mendojmë që është në interes të qytetarëve që kërkesat dhe adresimet e tyre t'i trajtojmë me prioritet.
**Burim Krasniqi:** Faleminderit, kryesues! I nderuar ekzekutiv, monitorues, kolegë asambleistë, të pranishëm! Kërkoj që pika e rendit të ditës "Raporti financiar" të shtyhet për një seancë tjetër, sepse raporti është i mangët dhe nuk e ka të përfshirë pjesën e investimeve kapitale. Raporti ka vetëm mallra dhe shërbime, shërbime komunale. Raporti është gjysmak dhe konsideroj që nuk është informatë e plotë për Asamble Komunale. Me këtë, asambleja po fillon të trajtohet si diçka jo e rëndësishme dhe veprim pas veprimi po nënçmohet. Pas bartjes së pikës së dytë si pikë të fundit, fillojnë raportet gjysmake, vijnë direkt në asamble ende pa kaluar në KPF. Është fakt që asambleistët paguhen, por është një fakt tjetër që ata kanë marrë vota prej qytetarëve. Nëse mendohet të bëhet "hajgare" me asamblenë komunale, gradualisht do ta dërgojmë drejt një drejtimi që të funksionojë në mënyrë jo të rregullt. Kërkoj mirëkuptim nga drejtori që kjo pikë të shtyhet për seancën tjetër!
**Kryetari:** Përshëndetje për kryesuesin, nënkryetarin, anëtarët e kuvendit, mediet, përfaqësuesit e LMT-së! Sa i përket që raporti financiar të shtyhet për një seancë tjetër, nuk mund ta bëjmë këtë. Ju lus që të mos insistoni, sepse e kemi për obligim ligjor dhe nëse raporti ka mangësi, këtu e kemi drejtorin e financave dhe mund të bisedoni me të. Është e qartë, raporti 3-mujor financiar është obligim ligjor. Sa i përket çështjes që lidhet me bartjen e pikës së dytë, në të fundit. Më besoni që ekzekutivi është i përgatitur si në fillim, si në fund. "Njërit që ia kanë pushtuar shtëpinë, ishin kapur te një shpuzore! Thoshte që këtë shpuzore nuk e lëshoj". Pika e diskutimeve nuk është shtëpia, është shpuzorja. Nuk ka kurrfarë rëndësie për ekzekutivin, se a është e dyta, apo e fundit. Për këtë çështje vendos kuvendi. Lutja ime është që të merreni me shtëpi, jo me shpuzore.
**Defrim Kafexhiu:** Kryetari e tregoi një "mesele". Unë besoj që shtëpia është duke u "kallë". Gjendja nuk është mirë në Komunë të Rahovecit. Ju edhe në shpuzore kapeni. Grupi i Aleancës e ka bërë propozimin, unë e thashë ekzekutivi, sepse kryetari me kryesuesin konsultohen për rendin e ditës. Ju lutem, që të mos bëni "hajgare" me ne, nuk është që ne po kapemi te shpuzorja, por ju. Ai që e bën propozimin, ai merret me çështjen, e jo opozita, në këtë rast ti që po na ofendon si tërësi.
**Kryetari:** As që e kam ndërmend të replikoj. Unë nuk e kam propozuar, as të dytën, as të fundit. Vendimi është i kuvendit. Secili grup e ka të drejtën të propozojë diçka. Nuk është me rëndësi për ekzekutivin, sepse drejtorët e drejtorive nuk kanë "lidhje" me parti politike, e nëse ju e përfaqësoni konceptin partiak, mirë, jeni të zgjedhur. Ndërkaq, unë jam kryetar i Komunës dhe këta janë drejtorë të drejtorive për të gjithë vendin. Në çfarë gjendje

është shtëpia, flasin ministritë, organizatat ndërkombëtare vendore e ndërkombëtare dhe raportet e tjera. Kur është "kallë" shtëpia, ne kemi qenë këtu. Tani nuk kallet, sepse i kemi marrë të gjitha masat që shtëpia të përparojë, të forcohet, të zhvillohet, si dhe mos të ketë mundësi askush tjetër ta "kallë". Ky vend ka njerëz të ndershëm që nuk merren me kualifikime "bajate" për një grusht vota. Unë e udhëheq këtë shtëpi, jam i zoti i shtëpisë bashkë me ju. Shtëpia është në këmbë të forta, jo pse unë jam kryetar, po pse jemi ne dhe qytetarët e Rahovecit nuk e meritojnë fyerjen e inteligjencës nga kushdo qoftë. Raporti 3-mujor financiar është obligim ligjor dhe shumë të dhëna i marrin prej thesarit, sistemit apo free balancit.

**Rasim Fazliu:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për ju, kryetarin, anëtarët e kuvendit, drejtorët dhe të gjithë monitoruesit që e përcjellin këtë mbledhje. Iu bashkëngjitem propozimeve të deritashme që pika "pyetjet dhe përgjigjet" të kthehet në vendin e dytë, sepse është më mbarë dhe më mire. Nuk duhet të humbasim kohë më shumë dhe të diskutojmë rreth asaj a ta kthejmë, apo jo. Jam për atë që kjo pikë të kthehet në vendin që ka qenë.

**Kryetari:** Po ia përkujtoj Rasim Fazliut që 2014-2017 ka qenë e fundit në rend dite, kur ka qeverisur z. Idriz Vehapi.

**Burim Krasniqi:** Ndonjëherë është interesant kur e dëgjon kryetarin kur thotë që është i të gjithëve, kjo është fakt, gjithashtu është fakt që përfaqëson një parti politike. Pa dashur të dukem i vrazhdë, tani ka më shumë se askund ngjyrosje politike. Gjithçka është politike. Është gabim nëse mendohet që asambleja është shkel e shko. Vendosin numrat, është fakt, por kur mbërrin një rezultat të numrave, nuk nënkupton sukses. Suksesi është më i madh sesa numrat. Thuhet që rritja është vlerë numerike, por kur rritja shoqërohet me etikën, disiplinën, moralin dhe ndershmërinë, atëherë kemi progres. Kur progresi shoqërohet me njerëzinë, moralin dhe shpirtëroren, kemi sukses. Këtu ka rritje, nuk ka as progres, as sukses. Nëse mendohet të jetë raporti në Asamble Komunale, për shkak që është obligim ligjor, atëherë le të jetë i kompletuar. Jemi të gatshëm dhe asnjëherë nuk e kemi kundërshtuar, që mos të dalim keq në performancë, por jo të bëni hajgare me asamblenë komunale. Raporti është gjysmak, nuk ka informata për investime kapitale në asnjë rresht. Në KPF është thënë që raportet nuk votohen, si e tillë nuk e kemi në KPF, por direkt në Asamble. Në Asamble vijnë gjysmë dhe kjo nënkupton hajgare me Asamblenë Komunale. Kjo rritja e numrave ka bërë që të mendoni "hajt se na e votojmë, në rregull jemi" votohet sot, por nuk dihet nesër.

**Kryetari:** Vetëm ta keni parasysh, e dinë edhe komunat e tjera, e di edhe Skender Hamza, që nuk janë obligative të shkojnë në KPF. Këtë nuk e thashë edhe për raportin financiar. Raporti financiar nuk është bërë gati për KPF, për shkak të rrethanave. Raportet nuk votohen dhe është rekomandim që çdo gjë që nuk votohet, jo domosdoshmërish të shkojë në KPF. Megjithatë, raporti financiar, kam insistuar të jetë në KPF, por nuk ka qenë gati, sepse jemi të ndërvarur edhe nga departamenti i thesarit, i buxhetit etj... Sa i përket asamblesë, unë vij këtu rregullisht dhe besoni që nuk më ka marrë malli (ndoshta edhe malli m'ka marrë për disa asambleistë), por vij sepse e kam ndjenjën e përgjegjësisë. Ka kryetarë komunash që dy herë në vit janë prezentë. Asnjëherë nuk e nënçmova Asamblenë, përkundrazi, me prezencën time e dëshmoj që e vlerësoj rolin e asamblesë dhe natyrisht që për mua gjithçka nuk është numër, prandaj nuk kam koalicion me askënd. Nuk është tema numër 1, "numrat". Mos harroni që në politikë ka edhe numra dhe unë jam i obliguar që ta respektoj një vendim të Kuvendit të Komunës, nëse votohet. Ju siguroj që jam kryetar i të gjithëve dhe nuk kam parti këtu në Komunë. Sa iu përket ngjyrosjeve partiake, është mirë veç të kemi kujdes, sepse nëse e shikojmë me shifra, ka mundësi që ndokush del jashtë, sepse thotë ma përmendi këtë e atë. Unë kam thyer rekorde për përfshirjen e subjekteve politike në plot procese.

**Burim Krasniqi:** Pa hezitim, në seancën tjetër jam i hapur t'i diskutojmë me emër, me mbiemër të gjitha faktet për çdo punësim.

**Hasan Përboqi:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar, kolegë, drejtorë, medie! Ky diskutim që po bëhet këtu, ju bën të kuptoni se sa i mirë ka qenë propozimi i grupit të Aleancës. Ende nuk jemi te pika e diskutimeve, e shihni sa kohë dhe sa energji po shpenzohet. Kur kalojmë te pyetjet dhe përgjigjet, përfshirë edhe replikat, do të zgjasin edhe 3 orë të tjera. Ne si grup nuk dëshirojmë ta relativizojmë dhe t'ia humbim

rëndësinë pikës, por konsiderojmë që ka një mori pikash me rëndësi më të madhe sesa pika "pyetje dhe përgjigje". Tjetra, nëse ne si kuvendarë jemi betuar që do ta mbrojmë interesin qytetar deri në moment të fundit, kjo i bie që duhet të qëndrojmë deri në fund të seancës dhe jo të largohemi dhe t'i bojkotojmë seancat. Sa iu përket numrave, deri sa është demokracia, çdo herë do të flasin numrat. Në Komunë të Rahovecit ka folur edhe progresi, prej 2018 që e kemi marrë këtë mandat, me performancë e dini se ku del Komuna jonë. Kjo nuk besoj që është vetëm numër dhe nuk është vlerësuar prej njerëzve që janë paguar prej Smajl Latifit, por është vlerësuar nga ambasadat e huaja dhe nga qeveria. Transparenca komunale - prej 2018-ës jemi në vend të parë. Në përfundim të mandatit të kaluar, jemi komuna që ka realizuar më së shumti premtime nga ato që i ka premtuar, kjo nuk është vetëm vlerë, këtu ka pasur progres.

**Rasim Fazliu:** Për hir të të vërtetës, unë kam qenë pjesë e legjislativit, atëherë kur e përmendi kryetari i nderuar, Smajl Latifi. Dua të them që nuk qëndron ajo që tha kryetari, që iu është marrë e drejta e fjalës etj... etj... Ne kemi asambleistë që sot janë drejtorë, gjithashtu nënkryetari ka qenë. E vërtetë është që numrat i kemi pasur (koalicion me LDK-në), numrat e bëjnë të vetën, sikurse këtu. Askush nuk duhet të jetë kundër numrave, por të drejtën e fjalës e ka pasur çdokush. Këtë desha ta potencoj, sepse qytetarët po na dëgjojnë dhe mendojnë që ka qenë e vërtetë.

**Ilir Pallqa:** I nderuar kryesues, kryetar, kolegë, drejtorë, të pranishëm! Shefi i grupit të Aleancës foli me shumë pompozitet, për moral dhe qëndrueshmëri. Kur fol për moral, duhet të flasësh edhe për punësime. Pastaj te anekdota: "Kur ke pula, s'ke pse zihesh me dhelprën". Kryetar, ti fole këtu si shef i grupit të Aleancës, për këtë diskutim është dashur të flisnin grupi i Aleancës dhe kryesuesi i Kuvendit, jo kryetari. Po e përmendni shpesh kohën e Idrizit. Ai ka humbur, ai është treguar arrogant, por ka humbur. As ti mos u përgjigj! Edhe ti ke me humb nëse nuk përgjigjesh!

**Hasan Përboqi:** "Baci Gani, a mundesh me bisedu pak me Faruk Mujkën, se kam apliku për këtë pozitë"

**Kryesuesi:** Faleminderit! Atëherë, pas diskutimeve të shumta, e vendosim në votim propozimin e Defrim Kafexhiut, që pika: "pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve", të kalojë përsëri si pikë e dytë. Po e vendosim në votim. Kush është "për"?... kundër?... abstenim?... Atëherë, 14 vota kundër, 14 pro. Kryesuesi e ka të drejtën e votës së dyfishtë dhe propozimi i kuvendarit Defrim nuk kalon. Të nderuar anëtarë të Kuvendit, e kalojmë në votim rendin e ditës. Kush është "për"?... kundër?... abstenim?... Me 15 vota pro dhe 6 vota kundër, votohet rendi i ditës për mbledhjen e katërt.

**1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:**

**Kryesuesi:** A ka dikush diçka rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim! Kush është "për"?... kundër?... abstenim?... Me shumicë votash nga anëtarët e kuvendit (20 vota), aprovohet procesverbali.

**2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, personave fizikë dhe juridikë, P- 71510057-01643-1, zk – Rahovec:**

**Afrim Oruqi:** Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë, anëtarë të Kuvendit. Bazuar në ligjet e aplikueshme, kryetari ju propozon të merrni vendim që të japim në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 vjet, pjesë e parcelës 01643-1, në sipërfaqe prej 73m$^2$ zk – Rahovec. Qëllimi ka të bëjë me rritjen e vlerës së pronës publike komuanle.

Ilir Pallqa: Ne për këtë pikë e kemi ditur, kur e kemi pa me një dasmë kryetarin Latifi me personin në fjalë. Pse po e mbani peng, a nuk e ka ndonjë pronë tjetër ai, që ta bëni si këmbim? Nuk është etike, është në rregull t'ua zgjidhni problemet qytetarëve, por jo t'i kushtëzoni!

**Burim Krasniqi:** Në KPF e kam thënë të njëjtën, që drejtori ka thënë nuk qëndron. Besoj që procesverbali i KPF-së të jetë korrekt dhe të argumentohet që drejtori nuk e ka thënë të vërtetën. Ka thënë që nuk kom informatë zyrtare

prej inspektoratit, që personi në fjalë ka bë uzurpim. Informatën që e kam prej drejtorit këtu shihet që prej procesverbalit të parë dhe në vazhdimësi potencohet drejt prej inspektoratit, veprimi i qytetarit. Është uzurpim arbitrar, inspektorati nuk guxon ta quajë ndryshe, sepse e obligon ligji. Unë ka punuar vetë inspektor. Ka diskrepancë në mes të procesverbalit dhe veprimeve, por gjithashtu ka vullnet prej investitorit për ta marrë në shfrytëzim, sepse ka ardhur personalisht në zyrë të drejtorit, mbi bazën e të cilit është lidhur një kontratë për shfrytëzim njëvjeçar me ekzekutivin. Nuk dua të hy te pjesa politike, është veprim dhe vullnet i secilit. Por, me të drejt ndoshta vjen puna që ne të mendojmë ashtu, sepse ashtu ka ndodhur ngjarja në raport me objektin. Janë ndalur punimet, është vlerësuar uzurpim, është kërkuar të hiqen muret e betonit dhe në anën tjetër është dhënë në shfrytëzim. Është e çuditshme kur kërkohet largimi i një "tezge" në Xërxë dhe vlerësohet uzurpim, si dhe ankesa shkon deri te Enti për Gjeodezi dhe Kadastër në Prishtinë. Në anën tjetër, kemi të bëjmë me punë të vrazhda dhe në raport të inspektoratit thuhet: përkundër asaj që inspektorati ka vepruar, qytetari ka tentuar ta vendosë pllakën. Konsideroj që kjo është direkt t'ia japim në shfrytëzim një njeriu që ka uzurpuar, sepse nuk hyn askush tjetër. Ai e ka një kontratë për shfrytëzim, ne dëshirojmë ta mashtrojmë veten dhe ligjin, duke e shpallur në ankand dhe në fund e merr Burimi (sepse kjo dihet). Ai kontratën e ka dhe nuk ka asgjë të keqe. Kërkoj mirëkuptim që të vazhdojë me atë kontratë. Është e palogjikshme që ligjvënësve t'u kërkoni ta përkrahin njeriun që e ka shkelur ligjin, apo uzurpatorin. Përndryshe, ajo që është thënë që nuk ka cilësim juridik prej inspektoratit, nuk qëndron. Atë që e ka thënë drejtori mund ta vërtetojmë prej procesverbalit të KPF-së së fundit. Kërkoj mirëkuptim, le të vazhdohet me kontratën që e ka, sepse po krijohet një precedent për dikë tjetër.
**Afrim Oruqi:** Po filloj me pyetjen e fundit, me asambleistin Burim Krasniqi. Është fat i mirë që mbahen procesverbalet dhe regjistrohen të gjitha ato që i kam thënë. Ju ftoj publikisht ta kërkoni procesverbalin nga sekretariati, ta lexoni dhe ta publikoni. Unë në asnjë rast nuk kam thënë që nuk kam informatë prej inspektoratit. Po ta them sot, atë që ta kam thënë në KPF. Të kam thënë që në moment kur kemi pranuar informatë me shkrim prej inspektoratit, kemi dalë në terren. Në moment, kur e kemi parë që preket prona publike, kemi marrë vendim. Kemi kërkuar prej pretenduesit që të tërhiqet prej pronës publike. Brenda afatit ligjor, ai e ka respektuar vendimin me shkrim dhe pronën e ka kthyer në gjendjen e mëparshme. Tutje, kam kërkuar prej inspektoratit ta verifikojë në terren nëse prona publike është liruar dhe nëse është kthyer në gjendjen e mëparshme. Kështu të kam thënë në KPF, kështu po të them sot. Në këtë rast nuk ka asgjë të fshehur, të gjitha dokumentet janë publike dhe të qasshme. Unë atë ditë në KPF të kam thënë, edhe sot përderisa po flasim, që nuk është uzurpator, sepse ka kontratë me Komunën. Në pyetjen e asambleistit Ilir Pallqa: unë sot po ju propozoj vendimin për ta marrë me qira, nuk jam në dijeni se kush e merr, sinqerisht. Përveç që marrim vendim, unë nuk e di se kë e keni parë në dasmë dhe në foto. Unë nuk kam dalë të prezantoj as foto, as dasmë, por kam dalë ta prezantoj një vendim të pronës komunale, për ta dhënë me qira deri në 15 vjet, duke mos precizuar as shkresë, as emër të personit. Kryesues, për pikat që i moderoj unë, asambleistët nuk vendosin nëse kam nevojë ta marr fjalën, ose jo. Ne jemi live këtu dhe nuk bën që për hir të ekonomizimit të kohës të mos përgjigjem. Njerëzit na shikojnë, ti e publikon këtë incizim më vonë dhe qytetarët thonë "çka po bën Afrimi, a është duke e nda pronën atje?" Nuk bëhet kjo punë kështu. Nëse vendosni që këtë pronë ta japim me qira, përsëri do ta votojmë bashkërisht një komision. Kanë me ofertu njerëzit në ankand. Aplikoni, paraqitni më shumë! Sipas ligjit, kush jep një cent më shumë, e merr.
**Burim Krasniqi:** Drejtor, po ta them me përgjegjësi! Kur flas diçka, jam shumë i kujdesshëm. Në KPF ke thënë që, prej anës së inspektoratit nuk e kam asnjë shkresë zyrtare kur personi në fjalë është cilësuar uzurpator. Nuk kemi uzurpim. Nëse vjen procesverbali i plotë do ta shohim. Nëse unë po e them të pavërtetën, publikisht do të kërkoj falje.
**Ilir Pallqa:** Drejtori po punon shumë, nuk ka kohë për rrjete sociale. Paraprakisht po të informoj, si dikur për punësime dhe të gjitha kanë dalë. Mbesa, shoqja ... Këtu, dihet kush do ta marrë, ai që ka dalë në foto me kryetarin

dhe që është anëtarësuar. Ti këtë e di më mirë se ne, por e ke retorikën interesante për ta bartur gurin andej e këndej. Nëse nuk ndodh kjo, unë jam parashikues shumë i dobët.
**Kryetari:** Besoj që gjithçka mund të qartësohet nëse ka mjegull. Drejtori është kompetent dhe di t'i shpjegojë dhe t'i argumentojë gjërat. Po ashtu, besoj që ne kemi të drejtë të dalim në fotografi me secilin, madje, unë dal në fotografi edhe me plot njerëz të tjerë. Unë mund të dal në fotografi edhe me ndonjë kriminel, sepse njerëzit afrohen. Të merremi vesh, nëse ka mundësi të kontribuojë inspektorati, janë tema që sqarohen. Ne kemi shumë palë që kanë kërkesa të ndryshme për dhënie në shfrytëzim dhe procedurat i dini të gjithë. Baza për të propozuar në Kuvend diçka të kësaj natyre, është e shëndoshë. Për hir të procedurës nuk është mirë të flasim me emra. Sa iu përket anëtarësimeve, ju lutem, unë nuk e di kush nuk është anëtar i Aleancës në Komunë të Rahovecit.
**Kryesuesi:** Faleminderit, kryetar! Atëherë, nëse nuk kemi diskutime të tjera, këtë pikë të rendit të ditës e vendosim në votim. Kush është "për"?... kundër?... abstenim?... Me 20 vota "për", asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon kjo pikë e rendit të ditës.
**3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-71510057-01643-1, zk – Rahovec:**
**Afrim Oruqi:** Të nderuar kuvendarë, para jush e keni propozim-vendimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-01643-1, për 15 vjet. Komisioni duhet t'i ketë 5 anëtarë, 2 nga kuvendi, 2 nga ekzekutivi dhe 1 nga shoqëria civile.
**Kryesuesi:** Atëherë, ftoj përfaqësuesit për propozimet e tyre.
**Hasan Përboqi:** AAK, propozojmë Valmir Gashin.
**Defrim Kafexhiu:** LVV, propozojmë Vlora Vuçitërnën.
**Melinda Iska:** PDK, propozojmë Armir Vuçitërnën.
**Lirigzon Kastrati:** LDK, nuk kemi propozim.
**Kryesuesi:** Atëherë, kush është "për" Valmir Gashin?... Kush është "për" Vlora Vuçitërnën?... Kush është "për" Armir Vuçitërnën?... Atëherë, kalojnë: Valmir Gashi me 18 vota "për" dhe Armir Vuçitërna me 17 vota. Nga LVV, Vlora Vuçitërna ka 10 vota. Si të tillë, e vendosim në votim. Kush është "për"?... Me 15 vota "për", asnjë kundër dhe asnjë abstenim, kalon pika e tretë.
**4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës – hapësirën e objektit të QKMF-së për shfrytëzim Ministrisë së Shëndetësisë:**
**Kryetari:** Ideja ka nisur nga Florie Boshnjaku në 2011, nuk është arritur të bëhet diçka konkrete për shkak të një pengese ligjore. Ka vazhduar me Idriz Vehapin, i cili ka bërë shumë për hemodializën, edhe pse ligji nuk e parapanë që kjo fushëveprimtari të vendoset edhe në Rahovec. Numri i pacientëve që i nënshtrohet hemodializës është rreth 30 vetëm nga Rahoveci. Ndërkohë, ju e dini që ne vazhdojmë ta bëjmë transportin e tyre dhe gjendja e tyre për shkak të problemeve që kanë, 2 ose 3 herë në javë, shkojnë në Prizren. Tani është bërë një organizim tjetër të institucioneve komunale, të Spitalit Rajonal të Prizrenit, të ShSKUK-së dhe të Ministrisë së Shëndetësisë. Jemi në situatën kur Ministria e Shëndetësisë ka kërkuar që ta marrë në shfrytëzim këtë repart. Sot, jemi para një momenti unik dhe të rëndësishëm dhe besoj që jemi dakord të gjithë. Reparti, plotësisht, bie në kompetencat e Ministrisë. Ju përkujtoj që Suhareka ka dështuar për një përpjekje të tillë, ndërkaq pas 13 vjetësh, te ne po vjen në shprehje dhe do të kemi shërbimet e para për pacientët e parë në hemodializë. Në aspektin ligjor, ne duhet të veprojmë së bashku dhe duhet ta miratojmë vendimin për dhënien në shfrytëzim. Shumë mirë kanë vepruar: Florije Boshnjaku, Smajl Latifi, Idriz Vehapi, Munib Durguti dhe tani iu bëhet zgjidhje apo trajtim pacientëve që kanë nevojë për hemodializë. Jam i lumtur për këtë dhe ju ftoj që pa asnjë hezitim ta votojmë një projekt, që ka nisur herët dhe shpresojmë që ka ardhur koha për realizim, me kompetenca nga ministria dhe me mirëmbajtje logjistike nga ne. Shpresojmë që ta kemi gati në qershor, ose në korrik.

**Burim Krasniqi:** Në emër të grupit të asambleistëve të LDK-së, e falënderoj secilin, prej atij të parit që e ka pasur idenë për themelimin e hemodializës në Rahovec, deri te kryetari që sot e kërkon përkrahjen për ta ndarë hapësirën. Do të jetë sfiduese te pjesa e stafit. Në bazë të informative që kam, do të jetë shumë sfiduese që ta sjellim një mjek të hemodializës në QKMF. Kësaj radhe nuk besoj që ka pasur ndonjëherë ndonjë ide që të jetë kundër kësaj pune. Kam informatë edhe nga Fehmi Cena, që edhe në atë kohë ka pasur përkrahje kjo punë. Kërkoj mirëkuptim që t'i rrimë gati te pjesa e stafit dhe pjesa e terapisë që e marrin pacientët pas hemodializës. Të jetë një koordinim mes shërbimit të hemodializës dhe të barnatores të QKMF-së, që të njëjtat terapi që i marrin në Prizren, të kenë mundësi t'i marrin në Rahovec. Përkrahjen e LDK-së për këtë pikë dhe për çdo tjetër që është në interes të përgjithshëm dhe vlerësojmë që është e mire, do ta keni pa hezitim. Ju përgëzoj për punën!
**Defrim Kafexhiu:** Dua të ndërlidhem te kjo pjesë. Është proces që është drejt fundit tani, edhe pse, është mëkat që është vonuar disa vite dhe aparatura ka qëndruar e mbyllur deri sot. Ne po ndihemi krenarë, si grup dhe si kuvend që ky proces po realizohet dhe pacientët janë ata që do ta gëzojnë funksionalizimin e këtij reparti pranë QKMF-së në Rahovec. Dëshiroj t'i falënderoj të gjithë ata që kanë kontribuar dhe ekskluzivisht ish-drejtorin e Shëndetësisë në kohën e Idriz Vehapit, z. Munib Durguti, që në një pjesë të mandatit të tij është marrë me funksionalizimin e këtij reparti, duke e shfrytëzuar kryetarin e partisë së tij në atë kohë, Ferid Aganin (Ministër i Shëndetësisë). Munibi tani është përkah neve politikisht.
**Hasan Përboqi:** Në emër të grupit të Aleancës e përshëndesim funksionalizimin e këtij reparti. E di që është bërë një mund i madh me vite të tëra dhe çdo drejtor i shëndetësisë i ka kontributet e veta. Po ashtu, edhe drejtoresha e tanishme, Saranda. Si grup, punëve të mira u qëndrojmë çdo herë pas. E përgëzojmë kryetarin dhe aktorët e tjerë që kanë marrë pjesë në këtë punë.
**Sejfullah Sejfullahu:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje kryetar, kryesues, drejtorë, nënkryetar! Gjithashtu edhe ne si PDK kemi fjalë të mira rreth këtij reparti. Lutemi që shumë shpejt të mbyllet ky repart, të mos ketë pacientë, duke u munduar t'i parandalojmë këto sëmundje.
**Vlora Vuçiterna:** Përshëndetje për të gjithë! Unë në emër të grupit të LVV-së dua ta falënderoj zonjushën Saranda Sallteku për punën që ka bërë. Padyshim falënderoj edhe Ministrinë e Shëndetësisë që na ka qëndruar afër dhe zëvendësministrin e shëndetësisë, z. Berisha.
**Kryetari:** Unë nuk shkova larg atje, por e kam harruar edhe Samir Mustafën! Kjo është sfidë, sepse nuk parashihet me ligj. E mbaj mend kur kam ardhur në vitin 2018, kam qenë në hetuesi, nuk jam frikësuar sepse kam qenë krenar. Munibi e disa të tjerë janë frikësuar bukur shumë. Pajtohem me Burimin kur tha që duhet të ushtrojmë presion rreth stafit. Padyshim ka qenë e lidhur shumë me këtë punë. Zëvendësministri Arsim Berisha, fati ka qenë që është i anës tonë dhe ka qenë bukur kontributdhënës, e falënderoj shumë dhe i falënderoj të gjithë ata që kanë bërë punë të madhe dhe tani i gëzohem faktit që komuna jonë del të jetë fituese për hemodializë.
**Merisa Sharku:** Përshëndetje për të gjithë! E përgëzoj dhe falënderoj çdo kontributdhënës që kjo gjë të ndodhë në qytetin e Rahovecit. Veçanërisht për inicuesen e kërkesës, sepse besoj që gjithçka ka filluar aty. Përgëzoj për guximin dhe e stimuloj edhe veten që të bëjmë këso kërkesa që në fillim duken të pamundura, por me punë arrihen edhe këto gjëra që kanë sfida të mëdha përpara.
**Kryesuesi:** Falminderit! Atëherë, të nderuar anëtarë, pikën e katërt e kalojmë në votim. Kush është "për"?... Konstatojmë që njëzëri (25 vota "për") votohet kjo pikë.
**5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës, P-01469-4, zk – Rahovec:**
**Afrim Oruqi:** Të nderuar anëtarë të kuvendit, para jush e keni propozimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-01469-4, zk – Rahovec me pronar: Shpata "Hilmi Hajrullaga", në vendin e quajtur Padinë. Qëllimi i shpalljes në interes të përgjithshëm të kësaj sipërfaqeje është që rruga pa dalje të bëhet kadastrale, të ketë zgjerim dhe kubëzim dhe të qasshme për komunitetin që jeton aty.

**Burim Krasniqi:** Drejtor, e diskutuam që vendimi është në rregull dhe numri i parcelës. Kjo rruga e zgjatur edhe pak rreth 18m llogaritet deri në fund. Pse nuk bëhet që të zgjatet deri në fund, që edhe parcela e fundit 01470-1 t'i ketë dimensionet e rrugës të njëjta? Në gjeoportal e mata dhe shihet që për 18m, nëse rritet sipërfaqja, edhe parcela e fundit do ta ketë rrugën e njëjtë. Të jemi të barabartë për të gjithë!
**Afrim Oruqi:** Paraprakisht, para se të shpallim interes të përgjithshëm, duhet të marrim miratimin e pronarëve. Bëhet fjalë për prona private, se është shumë ide e mirë që të zgjerohet rruga deri në parcelën e fundit. Mund të diskutojmë me pronarët dhe në seancat e tjera të vazhdojmë.
**Kryesuesi:** Atëherë, nëse nuk kemi diskutime të tjera, e kalojmë në votim. Kush është "për"?... Konstatoj që unanimisht (22) votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.
**6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizikë dhe juridikë, P- 71510069-01505-0, zk – Retijë:**
**Afrim Oruqi:** Para jush, kryetari propozon që ta japim në shfrytëzim pronën e komunës në Retijë. Terreni është fushor - malor në kufi me Mamushën, **P-01505-0** me sipërfaqe 27 ha 96 ari e 8m$^2$. Ne kërkojmë prej juve që të marrim vendim dhe ta japim në shfrytëzim për 40 vjet. Çmimi, ankandi dhe procedurat janë të parapara me rregullore. Qëllimi: kultivimi i bujqësisë.
**Burim Krasniqi:** Kërkoj falje, ndoshta duket që po diskutojmë shumë. Parcela është në fund të fshatit Retijë, në kufi kadastral me Mamushën. Një rast të ngjashëm e kemi pasur në anën tjetër të Retijës, nuk ka pasur shprehje të interesit për ta marrë në shfrytëzim. Për këtë zonë, a presim që dikush të shpreh interes, apo vetëm po marrim vendime, procedura dhe në fund asgjë.
**Afrim Oruqi:** Ka pasur interesim, kemi marrë vendim, mirëpo për shkak të kostos jemi në proces të fundit të ndryshimit të rregullores për taksa dhe tarifa. Besoj që në muajin maj do të jetë në Kuvend. Në pikën më lart e kemi cekur që pagesa fillon pas 36 muajsh, duke i dhënë afat atij disa vite që të investojë dhe të ketë kohë për leverdi.
**Burim Krasnqi:** Kërkoj falje! Tri vitet e para të jenë pa pagesë për t'i dhënë hapësirë të rimarrjes së vetes. Aty një pjesë është mal. A mund të ekzistojë mundësia që pas tri viteve ai të thotë që është mal, nuk kam leverdi dhe të tërhiqet? Është si shqetësim, jo paragjykim.
**Afrim Oruqi:** Në kufi janë dy parcela të Komunës, është fakt që ka edhe mal, por do të kujdesemi edhe për këtë. Konkretisht në shumicën e sipërfaqes që është mal, nuk ka dru.
**Kryesuesi:** Atëherë, nëse nuk kemi diskutime të tjera, e kalojmë në votim. Kush është "për"?... Konstatoj që unanimisht (21) votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.
**7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës:**
**Afrim Oruqi:** Sipas ligjit, ju kërkoj që të formohet komisioni për t'i zbatuar procedurat për parcelën në fjalë, në zonën e njëjtë, në Retijë. Komisioni duhet t'i ketë 5 anëtarë. Dy nga ekzekutivi, dy nga kuvendi dhe një nga sektori joqeveritar.
**Kryesuesi:** Ftoj anëtarët për propozimet e tyre.
**Hasan Përboqi:** AAK, Sinan Kryeziun.
**Defrim Kafexhiu:** LVV, Ilir Pallqën.
**Sejfullah Sejfullahu:** PDK, nuk kemi propozim.
**Burim Krasniqi:** LDK, nuk kemi propozim.
**Kryesuesi:** Faleminderit! Atëherë, kemi dy anëtarë nga kuvendi, Sinan Kryeziu (AAK) dhe Ilir Pallqa (LVV). Nga ekzekutivi janë: Besmire Bytyqi dhe Berat Duraku. Me këtë përbërje po e vendosim në votim, kush është "për"?... Unanimisht (22) kalon kjo përbërje e këtij komisioni.

**Sejfullah Sejfullahu:** Po kthehemi në pikën zero, që përsëri pikën e diskutimeve nuk bën ta kemi të fundit, sepse sot e kemi një pikë të rëndësishme sa i përket muzeut në Krushë të Madhe. Kemi edhe mysafirë dhe kërkoj mirëkuptim, sepse nuk kisha pasur qejf që sot të ballafaqohemi dhe të shtyhemi.
**Burim Krasniqi:** Unë kërkoj një ndryshim brenda rendit të ditës. Le të shqyrtohet tani çështja e muzeut të Krushës, që edhe mysafirët të lirohen dhe mos të mbahen këtu deri në fund, nëse janë këtu.
**Kryetari:** Natyrshëm, sot do ta diskutojmë të parafundit pikën e përgjigjeve dhe të diskutimeve. Mysafirët vijnë në orën tre.
**8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/ eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare (IEAAP):**
**Avni Morina:** Të nderuar të pranishëm, para jush keni një propozim-vendim për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/ eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare në Komunë të Rahovecit. Sipas udhëzimit administrativ, neni 151/2020, neni 6, pika 3.1 e këtij udhëzimi, DKA-ja ka propozuar dy anëtarë: anëtari i parë është Lulëzim Krasniqi, udhëheqës i Strukturave për Arsim nga DKA-ja, njëkohësisht është edhe kryesues i komisionit. Anëtarja e dytë: Vjollca Vuçitërna, drejtoreshë e IAAP “Selajdin Mullabazi – Mici”. Sipas udhëzimit administrativ, anëtari i tretë emërohet nga MAShT-i.
**Lirigzon Kastrati:** Një sqarim, komisioni përzgjedhës për institucionet arsimore që janë në varësi të komunës, ka këtë përbërje: dy anëtarë të komunës që propozohen nga DKA-ja, miratohet nga Kuvendi Komunal. Anëtari i parë është i punësuar në DKA dhe anëtari i dytë është njëri nga këta tre ekspertë: ekspert i pavarur i arsimit, drejtor i institucionit arsimor me performancë të lartë, përfaqësues nga këshilli i prindërve me ekspertizë në fushën e edukimit dhe anëtari tjetër caktohet nga MAShT-i. Ju e keni propozuar një drejtoreshë shkolle, në rregull. Te performanca: kur e keni bërë vlerësimin e fundit për drejtorë në komunën tonë?
**Avni Morina:** Konsiderojmë se performanca e drejtoreshës është në nivelet e kërkuara. Mos t’i kishte këto performanca, nuk do të ishte bërë drejtoreshë. Jemi në përputhje me udhëzimin administrativ. Performanca e mësimdhënësve nuk bëhet nga DKA-ja. Performancën e bën Inspektorati i Arsimit.
**Kryetari:** Drejtorja Vjollca Vuçitërna, ka pasur performancë të mirë me siguri, edhe në atë kohë kur e ka emëruar drejtoreshë të Arsimit, Idriz Vehapi. Ka vlerësim pozitiv. Më 4 dhjetor 2017, Idriz Vehapi e ka emëruar drejtore të shkollës, përsëri është një vlerësim. Performanca e fundit i është bërë nga komisioni përzgjedhës dhe nga kryetari i komunës. Kontribut në performancë ka dhënë edhe ky që po e shihni para vetës, Smajl Lafiti, sepse ia ka nënshkruar kontratën për drejtore të atij institucioni. Ajo ka pasur funksione të ndryshme, drejtoreshë dhe profesoreshë me përvojë. Fakti që ne e kemi zgjedhur drejtore përsëri, është performanca e mirë.
**Lirigzon Kastrati:** Nuk kemi asgjë kundër kandidates, por thjesht po i kontribuojmë procesit që mos të na kthehet vendimi. Unë thjesht e bëra një pyetje, kur është bërë vlerësimi i fundit i drejtorëve të shkollave?
**Avni Morina:** Duhet të dallojmë performancën profesionale (ku përfshihen edhe drejtorët e shkollave) me ndonjë performancë tjetër, që bëhet vlerësimi nga autoritetet e tjera. Nëse flasim për të parën, kjo është detyrë e Inspektoratit të Arsimit. Para dy viteve, disa drejtorëve iu është vazhduar mandati për hir të performancës.
**Defrim Kafexhiu:** Unë vetëm desha të ndërlidhem pak me komentin që e bëri kryetari për paraardhësin e atij. Tha që, Idriz Vehapi e ka vlerësuar performancën kur e ka emëruar si drejtoreshë të shkollës dhe pastaj në mandatin e Smajl Latifit, ajo u zgjodh prej komisionit. Është standard i dyfishtë. Përndryshe, kryetari po e mban në mend shumë mirë edhe datën 4 dhjetor 2017, sepse nëse e bën një kërkim të vogël në *google*, i del menjëherë ajo procedura e saj e zgjedhjes në pozitën e drejtores, që nuk është bërë në bazë të vlerësimit të performancës paraprake, që e ka pasur si drejtoreshë, sepse ajo është emëruar drejtoreshë në fushatë zgjedhore, në mes të raundit të parë dhe të dytë të zgjedhjeve të vitit 2017. Përndryshe, pyetja e Lirigzonit ishte shumë korrekte. Të paktën

Vjollca është dashur ta marrë një raport prej Inspektoratit Arsimor, që ta ketë vlerësimin e performancës për mandatin paraprak.
**Kryetari:** Thashë që kryetari Idriz Vehapi e ka emëruar drejtoreshë të Arsimit. Nuk mund të emërohet dikush drejtor i një sektori në qoftë se nuk ka vlerësim pozitiv. Pastaj, më 4 dhjetor është emëruar drejtore e Shkollës së Mesme Profesionale "Selajdin Mullabazi – Mici", pavarësisht që është përzgjedhur në kohë jo të duhur, por, ne jemi xhentëlmen dhe nuk ia prishim vendimin e asnjë kryetari të komunës. As për Naser Dulën, as për Vjollca Vuçitërnën. Vendimin e kam prishur në momentin kur ka ardhur një raport nga MAShT-i, apo nga policia. Të gjitha këto gjëra në vete janë performancë dhe mendoj që është propozim me vend.
**Shqipe Kryeziu:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Përderisa jam në fushë të arsimit, desha të kontribuoj edhe unë këtu. Lirigzonin e kam pasur nxënës. Lirigzoni është dashur të thotë që nëse ka kualifikim Vjollca, ose jo dhe a është e barabartë me kandidatin që pritet të hyjë në garë. Sa i përket performancës, ajo mbi 10 vjet është drejtoreshë shkolle. Përveç kësaj, Vjollca Vuçiterna ka rritje të numrit të nxënësve mbi 15 %.
**Burim Krasniqi:** Mosha e bën të veten! Dikush nxënës i dikujt, dikush profesoreshë e dikujt. Për kualifikimin e dimë që e ka masterin, se më kanë thirrur në telefon që kinse Burimi të ka kundërshtuar në KPF dhe më kanë treguar në telefon që masterin e ka të përfunduar. I kërkoj falje zonjës në fjalë që po e diskutojmë emrin e saj, por meqenëse votohet për emër, obligohemi të diskutojmë për emër. Nuk e kontestoj performancën, sepse i ka besuar edhe ish-kryetari i Komunës për të qenë drejtoreshë e DKA-së. Kryetar, ashtu siç keni respekt për Idrizin, besoj që keni respekt edhe për Ibrahim Kryeziun, si ish-kryeshef. Pse bën një drejtor i DKA-së të jetë drejtor shkolle në kohën e Idriz Vehapit dhe nuk bën një drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë të jetë Drejtor i QKMF-së, që dikur ia ka besuar Ibrahim Kryeziu? Kjo është kartë e dyfishtë. Kështu që, nuk e kemi problemin në raport me zonjën në fjalë.
**Kryetari:** Kërkoj falje prej Shqipes dhe Sinanit, por unë e kam më mik se ti Ibrahim Kryeziun. Unë i respektoj të gjithë ata që kanë kontribuar për këtë vend dhe tani ai po bën punë profesionale, dikur ka bërë më shumë punë politike. Një ndër kryeshefat që ma urojnë 17 Shkurtin është Ibrahimi, këta të tjerët fort nuk mërziten. Bile te përurimet, ju ftoj të merrni pjesë edhe ju. Në Celinë, shtëpia e kulturës, së pari është ide e Rasimit dhe kur shkova atje, nuk e pashë në përurim. Në kuptimin politik, merrni pjesë në angazhimet e juaja, sepse ka shumë ide që dalin prej Kuvendit.
**Burim Krasniqi:** Kryetar, më keqkuptove në atë që e thashë! Nuk e pata llafin te Ibrahimi, sepse e di respektin. Por, për shkak të respektit për Idrizin, drejtoreshën e arsimit e keni bërë drejtoreshë shkolle. Pse drejtorin e shëndetësisë të kohës së Ibrahimit, nuk e bëre drejtor të QKMF-së?
**Kryetari:** Në një situatë e kemi pasur kështu: Drejtoreshë e Shëndetësisë ka qenë Florije Boshnjaku. Unë e kam një stërnip, doktor shumë i mirë është, Shemsedin Popaj. Kërkonte të bëhej drejtor i QKMF-së. Nuk mund të jenë të Fortesës, drejtori dhe drejtoresha. Vetëm për këtë fakt, përndryshe të gjithë në QKMF kanë qenë për të. Ndonjëherë duhet të ruhemi prej "Avashllëkut të të rinjve dhe entuziazmit të të moshuarve". Pra, në qoftë se një i ri është shumë i ngadalshëm dhe nuk përkon me trendin ku jemi dhe në qoftë se një më në moshë është shumë entuziast, përsëri nuk përkon me realitetin. Jemi në kërkim të një të riu adekuat për drejtor të QKMF-së.
**Rasim Fazliu:** E falënderoj kryetarin dhe drejtorin e Kulturës që e kanë realizuar atë projekt. E gëzofshin qytetarët!
**Kryesuesi:** Atëherë, pikën e tetë e kalojmë në votim, kush është "për"?... kundër?... Me shumicë votash pro - 25 dhe 2 vota kundër, aprovohet pika e tetë e rendit të ditës.
**9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Arsim të Komunës e Rahovecit:**
**Skender Hamza:** Përshëndetje kryesues, kryetar, anëtarë të kuvendit! Para vetes e keni një vendim për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Arsim. Arsyeja është që nga radhët e Vetëvendosjes e kemi Leonard Morinën, që

është edhe anëtar i KPF-së dhe sipas udhëzimit është e ndaluar. Nga radhët e Vetëvendosjes kërkojmë një emër të ri.

**Ilir Pallqa:** Me gjasë unë do të jem i propozuari! Por, çka po ndodh me këtë komitet, a po mbahet apo jo?

**Fahrije Lushi:** Përshëndetje për të gjithë! Në pyetjen e Ilirit, nuk është organizuar asnjë mbledhje për arsyet që i kemi përmendur në mbledhjen e kaluar, si grup nuk kemi qenë i kompletuar.

**Kryesuesi:** Atëherë, pikën e nëntë e vendosim në votim! Kush është "për"?... Me shumicë unanime (25) aprovohet edhe pika e nëntë.

**10. Shqyrtimi i Raportit Financiar, janar – mars 2024:**

**Afrim Limani:** I nderuari kryesues, kryetar, nënkryetar, të nderuar asambleistë. Raporti financiar 3-mujor përbëhet nga dy pjesë kryesore. Pjesa e të hyrave dhe pjesa e realizimit të buxhetit. Në kuadër të këtij raporti nuk i kemi përfshirë aktivitetet e prokurimit, sepse është raport 3-mujor dhe nuk ka pasur ndonjë aktivitet të cilin mund ta fusim këtu. Pyetja e Burimit, i cili pyeti rreth investimeve kapitale: realisht e kemi një raport për investime kapitale, por nëse ka menduar për pjesën e obligimeve financiare dhe kontraktuale, që lidhen me raportin e investimeve kapitale, këto i kemi lënë për raportin 6 – mujor, që vazhdimisht këtë standard e kemi praktikuar nga viti 2021. Në këtë raport e kemi futur edhe një standard të ri, shpenzimet e klasifikuara brenda afatit kohor 30 ditë. Në investime kapitale, për këtë 3-mujor i kemi pasur 45 fatura. Prej tyre, 37 fatura janë realizuar dhe 8 kanë mbetur ende pa u paguar. Përndryshe, vlera e investimeve kapitale të shpenzuara, është: 1.728.649€ (30.59%). Të hyrat për këtë 3-mujor kanë qenë në vlerë prej 378.122€, nëse bëjmë krahasim me vitin e kaluar, e kemi një diferencë pozitive prej 19.163€. Në raport janë të përfshira edhe të hyrat në mënyrë analitike, sipas kodeve ekonomike. Shpenzimi i buxhetit, në total ka shkuar në 5.785.541€ (29.21%). Sa për informacion, ne jemi një ndër komunat më transparente sa u përket raporteve financiare.

**Burim Krasniqi:** Drejtor, faleminderit për raportimin dhe respektin! Por, kur ka respekt kaq shumë, është mirë të shkoni me të, t'i qëndroni afër komplet, jo vetëm respekt gojor. Në tabelën 3.1, faqe 7, janë të përmbledhur të gjitha shpenzimet sipas programeve. Totali i shpenzimeve kapitale është 1.728.649€, mallra dhe shërbime është 782.364€. Te pjesa analitike, e kemi komplet, sipas projekteve mallra dhe shërbime, nuk i kemi edhe investimet kapitale si informatë. Për këtë e thashë që në fund mungon pjesa e investimeve kapitale. Është kusht ligjor, kriter i performancës dhe për krejt çka ka nevojë, do ta ketë përkrahjen e LDK-së, sepse nuk ka të bëjë me individin, por me qytetarin. Te pjesa tjetër që dëshiroj të kërkoj vëmendje, është çështja e tatimit në pronë. Duke pasur parasysh që me ligjin e ri, shtëpitë nën 100m$^2$ nuk janë pjesë e tatimit në pronë dhe duke pasur parasysh zbritjen me ligj të ri. Unë po flas për veten, shtëpinë e kam 120m$^2$ dhe këtë vit tatimin në pronë më ka ardhur zero-zero. Të lutem, të rishikohen sipërfaqet e shtëpive të qytetarëve të Komunës së Rahovecit, sepse ai që e ka mbi 100m$^2$ e ka për obligim pagesën. Është jokorrekte që dikush të paguajë e dikush tjetër jo, për të njëjtën sipërfaqe që e ka.

**Defrim Kafexhiu:** Doja të ndërlidhem te çështja e të hyrave vetanake të Komunës së Rahovecit. Te çështja e taksimit të bizneseve. Shumë prej bizneseve po ankohen te kjo formë e taksave për aktivitetin sekondar të bizneseve. Të taksohet vetëm aktiviteti kryesor i biznesit është shumë në rregull, sepse shumica e bizneseve që themelohen si aktivitet sekondar e vendosin si opsion për të ardhmen. Komuna e Rahovecit është duke i taksuar sigurisht me normë të vogël, por sa mund të jetë humbja e Komunës së Rahovecit nëse nuk taksohen fare aktivitetet sekondare?

**Afrim Limani:** Burim, për pyetjen e parë, mendoj që ta dhashë në fillim përgjigjen. Në raportin 6-mujor do të jenë në detaje të gjitha. Për çështjen e tatimit në pronë: në dhjetor e kemi votuar një rregullore dhe të gjitha të dhënat janë në sistem. Në këtë rast edhe ty të ka kapur zero-zero edhe me 120m$^2$, nuk mund ta jap një informatë

të detajuar. Të ftoj në zyrë, për ta parë në sistem gjendjen më gjerësisht. Ndoshta arsyeja është që shtëpia është e regjistruar si vendbanim primar, mirëpo koeficienti i kualitetit të shtëpisë ndoshta nuk është "shkëlqyeshëm". Defrim, të them të drejtën, ndoshta unë nuk jam kompetent ta jap këtë përgjigje. Pajtohem me ty, ka dy javë që jemi duke punuar në këtë drejtim dhe shumë shpejt do të dalim me një ndryshim të rregullores për taksa dhe tarifa. Një prej çështjeve të diskutuara është edhe kjo që the, si do t'i trajtojmë këto lloj biznese.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Atëherë, kalojmë në pikën e njëmbëdhjetë.

**11. Shqyrtimi i informatës mbi implementimin e projektit të mirëmbajtjes dimërore dhe verore të rrugëve në Komunën e Rahovecit:**

**Përparim Krasniqi:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje kryetar, anëtarë të kuvendit, të pranishëm! Komuna e Rahovecit ka kontratë me dy kompani për mirëmbajtjen e rrugëve dimërore dhe verore. Periudha dimërore i bie prej 15 nëntor – 15 mars, ndërsa periudha verore prej 15 mars – 15 nëntor 2024. Gjatë sezonit dimëror, parashihet të mirëmbahen rrugët dimërore. Sivjet i kemi dy kontrata. Sa i përket mirëmbajtjes verore, Komuna e Rahovecit është e vetmja komunë që i mirëmban të gjitha hapësirat publike. I mirëmban edhe varrezat civile, të dëshmorëve dhe lapidarët. Mirëmbajtjen e hapësirave publike e bëjmë në bazë të rregulloreve të Demos-it.

**Ilir Pallqa:** Drejtor, cilat rrugë, përveç atyre rajonale, nuk janë në plan të pastrohen? Këto dy kompani a kanë pajisje për largimin e deponive ilegale dhe sa dënime janë dhënë për hedhjen e mbeturinave 2023-2024? A keni shikuar forma që t'i kapim banorët që hedhin ilegalisht? Gati çdo lagje është një hapësirë që hedhin papërgjegjshëm! A keni komunikuar me policinë, rreth kamerave të tyre dhe përmes atyre të vendosni gjobë? Nëse jo, pse nuk po e caktojmë ne një datë, p.sh. prej 1 qershorit t'i përcjellim kamerat dhe lajmi të bëhet publik. Do të ishte mirë edhe pse nuk e di sa kemi ne kompetencë ta bëjmë një gjë të tillë. Të bëhet edhe një takim këtu në kuvend, të propozojmë secili dhe të arrihet forma që ta zvogëlojmë këtë problem të deponive.

**Burim Krasniqi:** Kryesues, besoj që edhe ju e keni lexuar materialin para se të vini në seancë. Informata është më shumë informatë mbi kontratat e lidhura se sa mbi implementimin e projektit të mirëmbajtjes. Këtu i kemi kur fillon periudha verore dhe dimërore, i kemi që janë lidhur dy lote, si dhe e kemi se çka nënkupton me mirëmbajtje të hapësirës publike. Nuk e kemi informatën se sa rrugë janë mirëmbajtur, sa km i kanë bërë mjetet që e kanë pastruar borën? Sa kg kripë është gjuajtur? Sa hapësirë gjelbëruese është pastruar? Sa grupe janë sanuar? Sa rrugë i kemi të dëmtuara që është dashur të intervenohet? Konsideroj që informata mbi implementimin, jep informatë mbi atë që është kryer punë dhe jo mbi ato kontrata që janë lidhur. Pa keqkuptim, në informatë duhet të na informoni për punët e kryera në bazë të projeksioneve të kontratave. Përveç kësaj, të kërkoj publikisht që, kemi shumë rrugë që po dëmtohen për shkak të qytetarëve që kryejnë shërbime të caktuara: kanalizim, gyp të ujit etj... Duhet ta shohim formën e sanimit nga komuna dhe t'iu faturojmë atyre që bëjmë dëme, duke mos e marrë një pëlqim prej komunës. Nuk ka fshat që nuk ka rrugë të prerë, për shkak të intervenimit të qytetarëve që i kanë bërë individualisht. Rruga duhet të kthehet për një kohë të caktuar në gjendjen e mëparshme, në qoftë se ai që e pret rrugën dhe nuk e kthen siç ka qenë, atëherë duhet t'ia faturoni dënimin e merituar.

**Përparim Krasniqi:** Ilir, në muajin mars e kemi organizuar një takim këtu. I kemi ftuar kryetarët e fshatrave, ambientalistët, i kemi ftuar edhe anëtarët e kuvendit (nuk e di nëse keni pranuar ftesë), qytetarët, i kemi ftuar gjithashtu edhe OJQ-të. Kemi diskutuar që Komuna e Rahovecit do të marrë përsipër eliminimin e të gjitha deponime ilegale në territorin e vet dhe të njëjtën kohë të gjejmë forma përmes kryetarëve të fshatrave dhe individëve të caktuar t'i mbrojmë deponitë e pastruara. Kamerat e sigurisë në qytet i ka në menaxhim policia dhe jo komuna. Në këtë drejtim, inspektorati i ka shqiptuar disa gjoba. Ka raste kur keqbërësit i kemi identifikuar përmes faturave të ndryshme që janë hedhur. E kemi hapur një procedurë për kamera dhe jemi duke shikuar mundësinë të vendosim kamera në zonat afër deponive rreth zonës urbane. Burim, ajo që the është e vërtetë, por, p.sh. Komuna e Rahovecit mirëmban (mbledh mbeturina) edhe rrugë rajonale, e që nuk e ka fare për detyrë. Sa u

përket gropave dhe sanimeve, në email t'i kam dërguar statistikat. Sa u përket dëmtimeve, K.R.U. "Gjakova" bën shumë dëmtime për shkak gypave të vjetër që i ka. Sanime nuk ka bërë aq sa duhet.
**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtor! Të nderuar kuvendarë, kemi arritur në pikën e dymbëdhjetë. Kjo pikë do të diskutohet në orën 15:00, pasi do të vijnë profesorët nga fakulteti i Arkitekturës dhe i Antropologjisë, në mënyrë që të marrin mirënjohje për implementimin e "Muzeut të Masakrës" në Krushë të madhe. Me lejen tuaj, kalojmë te pika e fundit.
**13. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve:**
**Burim Krasniqi:** Kryesues, dy informata i kam kërkuar në KPF dhe le të mbeten për seancën e radhës. Besoj që Sekretaria e Kuvendit i ka përcjellë te drejtori ato dy informata të kërkuara. Drejtorin e arsimit nuk e kemi këtu, por dua ta shpreh një shqetësim. Sipas informatave që kam, ka ndodhur një arrestim i një arsimtareje në shkollën "Ardhmëria", për shkak të përdorimit të dhunës së tepruar në raport me nxënës. E kanë lajmëruar rastin në polici, policia ka intervenuar. E drejta ligjore e nxënësit dhe e prindit kur paraqitet dhuna, ekziston. Ajo që më ka shqetësuar më shumë është se, arrestimi (lidhja e duarve) është bërë në oborrin e shkollës. Uroj që mos të jetë ashtu dhe si Kryetar i Komunës, të kërkoj që të bashkëbisedoni me policinë. Nuk besoj që një arsimtare e ka nivelin e tillë që, kur ftohet prej policisë, mos të shkojë të lajmërohet në stacion policor. Pavarësisht veprimeve që i ka bërë në ambientet e shkollës, duhet të kujdesemi për imazhin e arsimtarëve në raport me nxënësit në atë shkollë. Uroj që të jem gabim në informacion. E dyta, kryetar, kam informacion që drejtorët e shkollave gati qe një vit, raportojnë direkt te ju. Pse po ndodh? A është arsimi shumë keq, apo ka mosbesim te drejtori i DKA-së? Unë e kuptoj që drejtori i DKA-së t'i përcjellë raportet e përmbledhura, por besoj që kuptimi i hierarkisë është prej drejtorëve të shkollave, te drejtori i DKA-së. Drejtoreshën e Shëndetësisë nuk e kemi. E kam një shqetësim shumë të vogël. Më datë 23.4, rreth orës 22:30, kam qenë duke shkuar në Gjakovë. Gjatë rrugës e kam parë autoambulantën e Komunës së Rahovecit vetëm me drita rrotative dhe pa alarm. Kryetar, 4-5 herë autoambulanta është vënë në rrezik në trafik. Është diçka simbolike, por që rrezikon komplet trupën e ndihmës së shpejtë. Kërkoj mirëkuptim që ta shprehni këtë shqetësim dhe besoj që është investim shumë minimal në raport me sigurinë që e krijon te ngasësi, stafi dhe pacienti. Drejtor i Kulturës, ku ka mbetur kompleksi sportiv? Nëse nuk gaboj, më 11 maj fillon rrënimi i stadiumit të qytetit, sipas informatave që i kam. Ku është gjendja e kompleksit atje dhe muri i betonit që është bërë, pse po mbulohet? A është bërë gabim si projekt?
**Lirigzon Kastrati:** Faleminderit, i nderuari kryesues! I nderuari ekzekutiv, kolegë anëtarë, qytetarë të Komunës së Rahovecit! Kemi disa kërkesa nga ana e qytetarëve të fshatit Hoçë e Vogël dhe Brestoc, sa i përket ndriçimit publik. Kërkojmë t'i përgjigjeni thirrjes së vazhdueshme të qytetarëve që të kryhet ndriçimi publik në lagjet të cilat nuk posedojnë dhe të rikthehet në ato lagje në të cilat është ndërprerë për shkak të ndërrimit të shtyllave. Çështja tjetër ka të bëjë me mirëmbajtjen e rrugëve fushore, meqenëse tani veçse jemi në sezonin bujqësor. Kërkoj që kjo çështje të merret me prioritet. Deri ku është arritur me kontratë si ekzekutiv? Pasi në seancat e kaluara keni deklaruar që këtë kontratë me disa operatorë e keni shkëputur për shkak të mospunës së tyre. Javë më parë e kemi pasur përvjetorin e dëshmorëve dhe martirëve. Kërkoj që varrezat e dëshmorëve në fshatin Hoçë e Vogël dhe Brestovc të rregullohen me një pllakë së paku në varrezat e tyre dhe të parandalohet dëmtimi i mëtutjeshëm, duke u mirëmbajtur në këtë drejtim. Për fshatin Brestovc, një kërkesë urgjente të Lagjes Elshani, për rregullimin e kanalizimit fekal. Këtë kërkesë, përfaqësuesi i lagjes e ka bërë vite më parë. Janë 60m kanalizim, ata janë në gjendje të mjerueshme me një kundërmim shumë të rëndë të erës. Te mirëmbajtja e objektit të AMF-së në fshatin Brestovc: Unë e kam vizituar objektin ditë më parë dhe ka filluar që të dëmtohet, dyert janë të hapura dhe ndriçimi është thyer, sigurisht nga njerëzit e papërgjegjshëm.
**Hasan Përboqi:** Unë e kam një pyetje për drejtorin e Kulturës dhe Sportit, si po shkojnë punimet në qendrën për kulturë, arte dhe inovacion? Arsyeja që po e bëj këtë pyetje është se aty ka hapësirë buxhetore më shumë, qoftë prej ministrisë dhe prej komunës dhe a mundet që kompania e kontraktuar t'i realizojë punimet, të arrijë që t'i shpenzojë të hollat, sepse është një projekt shumë i mirë.

**Edona Kryeziu:** I nderuari kryetar i komunës, z. Smajl Latifi, i nderuari kryesues, drejtorë të drejtorive, asambleistë. Kryetar, gjatë fushatës, qytetarëve u keni premtuar shpërndarje të mjeteve bujqësore. Përfituesit që u ka dalë emri në listë e kanë kryer pagesën, ashtu siç është e paraparë me rregullore, me participim, që nga viti 2022. Që nga ky vit, banorët e komunës sonë janë në pritje të këtyre mjeteve. Bujqve nuk jeni duke iu lehtësuar punën, pos duke iu vështirësuar. Çfarë po ndodh me këtë subvencion dhe pse nuk janë shpërndarë ende këto mjete bujqësore?
**Fahrije Lushi:** Faleminderit, kryesues! I nderuari kryetar, të gjithë të pranishëm! Dua të ngre një shqetësim që ka të bëjë me problemin me rrjetin e kanalizimit në fshatin Ratkoc. Ndërlidhet drejtpërdrejt me shtëpinë time, sepse është afër. Problemi vjen nga rruga "Batalioni i tretë" deri te rruga "Visar Hoti". Sa herë që ka të reshura, aty grumbullohet uji. Pastaj është një problem tjetër, aty vazhdon të rrjedhë uji. Nuk e di nëse është në kompetencë të komunës, apo nga KRU "Gjakova". Me kërkesë të veçantë, kujt duhet t'i drejtohemi?
**Rasim Fazliu:** Faleminderit, kryesues! Unë dua ta ngre një çështje përsëri! Kur një kërkesë nuk kryhet, atëherë duhet të përsëritet, apo jo? Në mandatin e kaluar e kemi diskutuar shumë herë çështjen e rrugës Fortesë – Celinë. Jemi në vit të dytë të këtij mandati, e kemi ngritur përsëri çështjen disa herë dhe përsëri nuk ka asgjë. Pyetja është se kur do të merrni masa konkrete, sepse është rrugë shumë e frekuentuar. Rruga është aq e dëmtuar, sa që është bërë e mërzitshme të kalojmë aty. Nuk po flas për kritikë, por gjendja është faktike dhe rruga vazhdon të jetë në gjendje të keqe.
**Defrim Kafexhiu:** Faleminderit për respektin! Së pari e kam një pyetje për ekzekutivin në lidhje me bursat për studentë dhe për kryetarin dhe drejtorin e Arsimit, pse po ndahen prej subvencioneve të zyrës së kryetarit dhe Drejtorisë së Arsimit, përderisa është një rregullore në kuadër të Kuvendit për ndarje të bursave? A është arsyeja e ndarjes së bursave në këtë formë vetëm për përftim politik të Aleancës, sepse sipas rregullores në fjalë, duhet të formohet komisioni prej tre anëtarësh nga Kuvendi i Komunës, një anëtar nga ekzekutivi dhe një përfaqësues të jashtëm, i cili i propozohet Kuvendit. A është i vërtetë dyshimi që ju po i ndani subvencionet nga Drejtoria e Arsimit për t'i shfrytëzuar bursat politikisht dhe për të mos lënë asnjë anëtar të kuvendit të përfshihet në komision?! Sot dua ta bëj një propozim në lidhje me ndarjen e bursave të studentëve, që bëhen nga Komuna e Rahovecit. E kam shprehur edhe më herët çështjen e kuadrove dhe për nevojën e profesioneve deficitare, sidomos në arsim. Si rrjedhojë e kësaj, duke parë që shumë vite radhazi forma e bursimit është vlerë e njëjtë e subvencionuar dhe duke pasur parasysh rrethanat e kohës, tani kjo formë duhet ndryshuar. Vitin e kaluar është themeluar edhe qendra për zhvillim në karrierë në IAAP – "Selajdin Mullabazi – Mici", pra, në koordinim me këtë institucion, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, drejtorinë e shkollës, Komunën e Rahovecit, me prindërit dhe me nxënësit, propozoj që vlera e subvencionimit të bëhet në 250€ në muaj për maturantët që fillojnë studimet për herë të parë, rrjedhimisht të ulet numri i përfituesve, duke i shpenzuar të njëjtat mjete buxhetore, por me kusht që me marrëveshje në mes të nxënësve dhe shkollës që t'u "imponohet" studimi nëpër drejtime deficitare. Fillimisht, të bëhet një komision i përbashkët në mes të Kuvendit dhe Ekzekutivit. Veçanërisht mësimdhënësit të bëjnë vlerësimin për kuadro deficitare, pastaj Qendra për Zhvillim në Karrierë të bëjë përzgjedhjen e nxënësve më të mirë, më me vullnet, sipas klasifikimt lëndor. Të diskutojnë me nxënësit dhe prindërit e tyre për këtë mundësi që ofron Komuna e Rahovecit dhe të njëjtit të takohen edhe me kryetarin e Komunës, si dhe në fund të nënshkruhet marrëveshja, e cila përpilohet nga komisioni i përbashkët, ku do të përfshihen të specifikuara kushtet. Marrëveshja të jetë për tre vjet dhe të nënshkruhet çdo vit pasi të përfundojë viti i studimeve, sipas kritereve minimale të vendosura. Shembull: në bazë të kalueshmërisë së vitit akademik, apo të notës mesatare dhe të nënshkruhet edhe për vitin e dytë e kështu me radhë... Pra, sipas këtij propozimi, përafërsisht për tre vjet e gjysmë, nëse planifikimi do të jetë në rregull, Komuna e Rahovecit do të ketë studentë të mjaftueshëm në drejtime deficitare. Sipas këtij stimulimi, këta studentë do ta kenë të garantuar vendin e punës menjëherë pas diplomimit. Kjo është zgjidhje e mirë për Komunën dhe për prindërit të cilët do ta ndiejnë ndihmën e institucionit, duke mos i llogaritur si barrë shpenzimet e studentit. Nëse ky propozim duket ndryshim i madh nga forma aktuale e subvencionimit, për shkak të detyrimit për të ulur numrin e bursistëve për ta jetësuar këtë propozim me të njëjtën vlerë të subvencionimit, atëherë, mund ta shtojmë vlerën e subvencionimit për 25.000€ dhe prej tetorit të këtij viti ta provojmë një

mbështetje të tillë me 10 studentë dhe në vitet vijuese të ndryshojmë formën në tërësi, sipas suksesit që do të kemi në vitin akademik 2024/2025.

**Kryetari**: Po! Rasim Fazliu e di që në rrugën Fortesë – Celinë ka pasur intervenime, por, përsëri nuk ka zgjidhje. Për të bërë zgjidhje stabile, kemi të bëjmë me pengesa që shkaktojnë pronarët privatë. Sidoqoftë, jam dakord dhe jemi duke e pritur një kontratë sa më shpejt dhe së paku të bëjmë riparime. Te bursat: unë nuk jam i lumtur që ende nuk kemi shpallur thirrje për bursa, për shkak që na ka ndodhur një situatë të gjitha komunave: Mbulimi i shpenzimeve të varrimeve, deri tani janë bërë nga kategoria mallra dhe shërbime, tani e presim funksionalizimin e vendimit bartje të mjeteve. I kemi rritur subvencionet, sepse nuk kemi mundur t'i lëmë keq shpenzimet e varrimit dhe njëkohësisht subvencionimin për bursa. Shpërndarja e bursave bëhet sipas një rregulloreje dhe sipas kritereve. Numri i bursistëve nuk është i vogël, është 174 dhe kësaj radhe i kemi futur edhe këta të shkollës së mesme, si shenjë për orientim në karrierë. Nuk kemi mundësi t'i rrisim subvencionet sa mendojmë ne, jam plotësisht dakord me ty. Përndryshe, nuk ka të pakënaqur në ndarje të bursave, sepse kemi shkuar në bazë të disa kritereve. Nëse është familje dëshmori, student i dalluar, nëse ka drejtim specifik etj... Te ndarja e bursave është një komision, i cili është në përputhje me rregulloren për ndarje të subvencioneve dhe auditori na ka thënë që jemi në rregull. Jam dakord dhe jam i gatshëm të bisedoj me ty, pasi e paske edhe të përgatitur materialin. Shumë shpejt do ta hapim thirrjen për bursa, jemi vonuar, por na ka kushtëzuar subvencionimi i mbulimit të shpenzimeve të varrimit. Te Fahrije Lushi: po, ka probleme me kanalizim në Ratkoc. Disa zgjidhje nëpër disa lagje kanë përfunduar, ndërsa aty afër rrugës rajonale është problem ekskluziv i KRU "Gjakovës". Bukur shumë gjoba ia kemi shqiptuar KRU "Gjakovës" dhe gjobat që bëhen për moskthimin në gjendje të mëparshme janë të larta deri në 5000€. Kolektori i madh besoj që do t'u japë zgjidhje disa problemeve që janë me vite dhe që herë pas here prodhojnë edhe defekte. Edona Kryeziu: vetëm 9 persona nuk kanë marrë, kanë participuar, por ende nuk kanë marrë mekanizëm bujqësor, sepse ka hendikep furnitori. Prej 3200 bujqve, vetëm 9 veta nuk kanë marrë dhe këtë e kemi sfidë dhe nëse nuk arrihet furnizimi, do të gjejmë formë t'u kthejmë paratë. Hasan, qendra kulturore është duke ecur mirë dhe ka fonde. Është i vetmi projekt në të cilin, siç thotë Afrimi, jemi komod. Lirigzon, AMF-ja në Brestovc, disa herë ka pasur pauza dhe nuk them që është në gjendje të mirë, por qëllimi ynë është të jetë funksionale dhe të punojë përditë. Do ta porosis drejtorin e QKMF-së dhe do t'i kërkoj të shkojë për vizitë atje. Te kanalizimi në Hoçë të Vogël e kemi bërë një pastrim dhe është e vërtetë që ka problem pak edhe aty, por problemi më i madh është mungesa e kolektorit dhe, siç e dini, kanë filluar procedurat e prokurimit për rregullimin e kolektorit të madh të ujërave të zeza dhe trajtimi i shtratit Hoçë e Madhe – Brestoc, Hoçë e Vogël – Nagac, deri në Krushë. Një pjesë e konsiderueshme nga granti i performancës është dedikuar për këtë qëllim. Te rrugët fushore, kemi shpallur procedurë të prokurimit dhe jam treguar korrekt me ju, që me shumë operatorë kemi pasur sfida. Presim të kemi kontratë të re. Kontratë kemi edhe për zgjerimin e ndriçimit publik dhe nuk besoj që asnjë komunë nuk është më mirë se ne me ndriçim publik, si dhe kompania i ka 10 vjet mirëmbajtje të ndriçimit publik. Te kompleksi sportiv: projekti e ka paraparë murin dhe muri ekziston, por për të ardhur deri te nivelizimi, muri është dashur të mbulohet, jo për ta nxjerrë nga funksioni, por që mos të duket vrazhdë. Aktualisht, është duke ndodhur drenazhimi i fushës dhe ne jemi marrë vesh me FFK-në për terrenin sintetik. Shpresojmë që kompleksi sportiv, përkundër vonesave të paparapara, sa më shpejt të realizohet është më mirë. Incidentet në shkolla: ka incidente dhe ndodhin ato. Para 3 dite e kam pasur një takim me drejtorët e shkollave dhe kryetarët e këshillave drejtuese, fatkeqësisht policia ka munguar dhe iu kam tërhequr vërejtjen seriozisht. I kam kërkuar drejtorit të arsimit t'ia dërgojë një shkresë, sepse dikush nga stacioni policor duhet të jetë i pranishëm në takime të tilla. Përkundër kësaj, jemi ende mirë me siguri në shkolla, sepse ne në vazhdimësi po marrim masa preventive, përmes takimeve të ndryshme. Pse raportojnë drejtorët e shkollave? Unë kam kërkuar vetë, është një praktikë e re dhe jo domosdoshmërish janë të obliguar të raportojnë. Dua ta mbaj vëmendjen nga drejtorët se çka po ndodh në shkollat tona. Shumë herë ia keni bërë këtë lloj pyetjeje drejtorit të Arsimit, por në fund, Edona do të thoshte, kryetar çka po bëni në këtë drejtim? Meqenëse kryetari, në një farë mënyre, e ka kompetencën ta ngarkojë dhe shkarkojë një drejtor, unë edhe personalisht dëshiroj të kem informatë, pavarësisht edhe rutinës dhe raporteve që i ka DKA-ja me drejtorët përkatës. Është një instrument shtesë, që unë do të jem më i përgatitur paraprakisht në takim me ta. Autoambulanta dhe autoambulacë

– Kjo që e vozit shoferi është autoambulantë, ndërsa ajo që është statike është ambulancë. Autoambulanta në Rahovec, në qoftë se ka vozitur pa kriter, apo pa shenjat lajmëruese, është gabim. Faleminderit për kontributin! Ne tani i kemi të ftuar profesorët, dhe shefat e grupeve do të ishte mirë të mbajnë nga një fjalim.

**Kryesuesi:** Faleminderit, kryetar! Për pyetjet e tjera të parashtruara, ftoj drejtorët e drejtorive përkatëse që t'u përgjigjen në mënyrë elektronike.

**12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e Muzeut të Masakrës në Krushë të Madhe:**

**Kryesuesi:** Me prezencën e tyre na kanë nderuar: Fazli Gajraku – drejtor i Bibliotekës Kombëtare në Prishtinë, Arsim Canolli – profesor i Antropologjisë në Fakultetin e Filozofikut, Tahir Latifi – udhëheqës në Departamentin e Antropologjisë. Studentët nga Sociologjia dhe Fakulteti i Antropologjisë: Redona Berisha dhe Çlirimtare Jonuzaj, Selami Hoti – kryetar i fshatit Krushë e Madhe.

**Kryetari:** Faleminderit, kryesues! Të nderuar anëtarë të Kuvendit, përfaqësues nga fshati Krushë e Madhe, kryetar i këshillit të fshatit. Sot jemi në një moment të rëndësishëm dhe njëkohësisht të veçantë. Pas disa elaborimeve që do t'i bëjnë edhe profesorët e nderuar e që kanë kontribuar që ky muze të themelohet, ne do të kërkojmë votën e anëtarëve të Kuvendit. E përshëndes Profesor Dr. Arsim Canolli, U.D. drejtor në Bibliotekën Kombëtare, z. Fazli Gajraku, prof. Tahir Latifi. I përshëndes studentet: Redona Berisha dhe Çlirimtare Jonuzaj. Ka qenë një punë që ka nisur herët, pas një bashkëbisedimi me kryetarin e këshillit të fshatit, për ata që kanë përjetuar tragjedi në Krushë të Madhe, me ish-ambasadorin Kosnet dhe bashkëshorten e tij dhe sikur është akceptuar ideja që të bëjmë diçka dhe të kemi një situatë në kuptimin pozitiv. Tani kemi mbi 200 intervista nga të mbijetuarit nga masakra e madhe në Krushë të Madhe më 25, 26, 27 mars. Nga zemra i falënderoj të gjithë ata që kontribuuan për këtë muze, që në bashkëpunim me krushjanët, kemi arritur ta hapim muzeun më datë 26 mars, në përvjetorin e 25-të të asaj që ka ndodhur në Krushë të Madhe dhe rrethinë. Publikisht e falënderoj edhe Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale për bashkëfinancimin në ndërtimin e muzeut. Ne, shpresojmë që do të kemi marrëdhënie të reja në përparimin e këtij muzeu dhe të plotësimit në shumë aspekte të tjera në të ardhmen. Të gjithë profesorët dhe studentët, ndihmën e tyre e kanë dhënë në baza krejtësisht vullnetare, pra pa asnjë lloj përfitimi materialo-financiar. I përgëzoj për përkushtimin e tyre në këtë projekt. Ky lloj muzeu, për bindjen tonë, është i vetmi në Kosovë dhe shpresojmë që të ketë shumë vizitorë, sepse njerëzit kanë çka shohin, kanë çka lexojnë dhe kanë çka dëgjojnë dhe të informohen në atë se çka ka ndodhur në Krushë të Madhe më 25, 26, 27 mars. 148.918€ është vlera e kontratës, punët shtesë janë 14,.804€, ndërsa në fazën e fundit që ka qenë specifikacion nga profesorët, ka qenë 33 mijë €. Totali i investimeve kapitale është 195.000€. Qëllimi i themelimit të vendimit është mbledhja, sistemimi, ruajtja e artefakteve, dokumenteve dhe gjësendeve të të vrarëve dhe të të zhdukurve me dhunë nga forcat shtetërore serbe në Krushë të Madhe. Muzeu ka për qëllim dokumentimin e krimeve serbe në marsin e vitit 1999, respektivisht paraqitjen e fushatës së vrasjeve, djegieve, shkatërrimeve dhe spastrimit etnik të kësaj zone, si dhe paraqitjen reale të krimeve të bëra nga forcat serbe, duke përfshirë vendet e ekzekutimeve, djegien e kufomave dhe prezantimin e dhunës sistematike ndaj banorëve të kësaj ane. Muzeu ka vlerë kulturore-historike dhe është i ndarë në kënde, ku do të ekspozohen dëshmi të ndryshme që pasqyrojnë fragmente të jetës së personave të vrarë, të grave, të fëmijëve, të mësuesve dhe të njerëzve të paarmatosur. Ju ftoj ta votojmë njëzëri!

**Kryesuesi:** Faleminderit, kryetar! Mirëseardhje i dëshirojmë edhe Samir Hoxhës – drejtor i Qendrës për Trashëgimi Kulturore në Prizren.

**Fazli Gajraku:** Përshëndetje! I nderuar kryetar, asambleistë, profesorë, profesionistë të fushës. Siç e dini, biblioteka kombëtare e Kosovës, bashkë me degën e Antropologjisë, ka hartuar një projekt për të mbledhur dëshmi mbi masakrën në Krushë të Madhe. Po bëhen disa vite punë të mundimshme, të mundimshme edhe për ata njerëz që i kanë përjetuar vuajtjet në atë që kanë parë në masakrën e Krushës. Jemi në finalizim të këtij projekti. Është duke u përgatitur botimi në 10 vëllime i dëshmive të masakrës me transkriptë për secilën intervistë. Punë kolosale në konceptimin e muzeut të Krushës kanë bërë profesorët e nderuar. Sinqerisht është një muze model për ta vizituar. E falënderoj kryetarin e Komunës për mbështetje gjatë gjithë kohës! Ky projekt ka qenë një ndër projektet më frymëzuese në karrierën time.

**Arsim Canolli:** Faleminderit shumë! E kam përgatitur një fjalim të shkruar, sepse ne që japim mësim ndonjëherë dimë ta zgjasin shumë, e ju jeni lodhur tërë ditën. I nderuari kryesues Arbër Zenuni, kryetar Latifi, asambleistë, krushjanë. Jam fort i nderuar që jam këtu së bashku me kolegët e mi, profesorë, studentë dhe hulumtues, ditën kur po themelohet zyrtarisht Muzeu i Masakrës në Krushë të Madhe. Dua t'ju përgëzoj ju të gjithëve si kuvendarë dhe krushjanët, për këtë akt të rëndësishëm. E përgëzoj dhe e falënderoj shumë Kryetarin Latifi, që e ka shtyrë para këtë punë të nevojshme dhe prijatare në këtë fushë në Republikën e Kosovës. Kjo komunë dhe ky rajon ka dhënë dhe ende jep personalitete që kanë shërbyer për të ngritur kushtetutën e lirisë së këtij vendi, me gjak, djersë dhe mendje. Ky muze duhet të çmohet dhe të merret shembull nga të gjitha komunat e tjera. Ju si komunë, sot vulosni hapin e parë institucional dhe juridik për të ruajtur kujtesën e mbledhur të të mbijetuarve të masakrës në 200 intervista dhe në shumë artefakte-dokumente, jo vetëm për ju, por për të gjithë botën. Kemi pasur fatin dhe nderin, që disa prej nesh, të jemi ata që do t'u ndihmojmë sadopak krushjanëve që ta realizojnë punën e tyre. Prej idesë deri te realizimi, krushjanët kanë qenë në qendër të punës. Ata kanë drejtuar punën dhe ne vetëm kemi ndihmuar. Ky muze është në fazën e tij të parë, me një ekspozitë, e cila ka nevojë të plotësohet me më shumë rrëfime dhe me mirëmbajte të duhur. Me aktin e themelimit, sot, mund të hyni në fazën e dytë. Faza e dytë është plotësimi i kushteve për qëndrueshmërinë e muzeut dhe peizazhin kujdesor të fshatit. Ky peizazh nënkupton shënimin, ruajtjen dhe inkuadrimin e lokaliteteve të tjera të fshatit, sidomos të krematoriumit të familjes së Nezir Mejdi Durakut, ku janë djegur trupat e mbi 40 të vrarëve dhe të të masakruarve. Ajo është shenjë e rëndësishme, jo vetëm e masakrës së Krushës, por edhe e gjithë Kosovës. Ai objekt është zemra e dhimbjes sonë. Aty nuk duhet të dështojmë. Ju bëj thirrje edhe juve dhe kryetarit, i cili ka vullnet shumë të madh, që të bëni zgjidhje për ta ruajtur dhe për ta kthyer në mbrojtje. E di që gjendja aty është e komplikuar, por duhet të krijoni mundësi që të gjeni një zgjidhje. Të krijoni staf për muzeun, të krijoni një dhomë druri apo kioskë me mundësi qëndrimi aty për zyrtarin Irfon Ramadani, sepse ai duhet të ketë kushte dhe staf. Muzeu ka nevojë për cicëron dhe mirëmbajtje. Ai është muze kombëtar dhe besa edhe ndërkombëtar. Kryetar, një gjë tjetër, ju lutem që të gjeni zgjidhje që muzeu të jetë i hapur të shtunën dhe të dielen. Mund ta mbyllni të hënën, ndoshta edhe të martën, por në fundjavë duhet të jetë hapur. Për fund, dua të falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët në këtë punë, që janë shumë! Ndjesë për emocionet!
**Tahir Latifi:** Faleminderit! Përshëndetje për kryesuesin, kryetarin, kolegët e mi, asambleistët, banorët e Krushës! Ideja fillestare ka nisur prej 2020 dhe tani kanë kaluar 4 vjet. Ideja fillestare ka qenë dokumentimi i masakrës përmes intervistave gojore, më pas Komuna e Rahovecit, në bashkëpunim me Agjencinë për Trashëgimi Kulturore, e kanë ndërtuar muzeun. Ne e kemi parë të arsyeshme t'i ndihmojmë Krushës për përgatitjen e konceptit të Muzeut dhe njëkohësisht ka qenë privilegj për ne. Në të dyja fazat, përveç profesionalizmit që është treguar, sfiduese për ne ka qenë edhe ana emocionale, duke marrë parasysh temën e trajtuar. Nuk dua ta zgjas më shumë. Ajo që duhet bërë, siç e tha kolegu Arsim Canolli, është mirëmbajtja e muzeut dhe të jetë i qasshëm për vizitorë. Sigurisht që pas pak kohe do të futet edhe në guida të ndryshme.
**Sejfullah Sejfullahu:** Faleminderit, kryesues! I nderuar kryetar, profesorë, drejtorë, studente. Unë më tepër dola t'i falënderoj të gjithë dhe ta përshkruaj pak emocionin se si ndihet një krushjan kur shkon në muze! Sot nuk duhet të flisja për muzeun, sepse sot muzeu flet për të gjithë ne. Artefaktet dhe dëshmitë e familjarëve tanë të zhdukur, flasin për masakrën dhe gjenocidin serb ndaj qytetarëve tanë, 25 vjet më parë. Dola këtu t'ju falënderoj të gjithëve ju që kontribuat, sepse ky muze po flet më shumë se mijëra e mijëra fjalë, që i kemi folur ne qe një çerek shekulli. Deri më tani, Kosova, shqiptarët dhe miqtë tanë ndërkombëtarë, kanë qenë me ne dhe kanë qarë gjithashtu vetëm me 26 mars – në datën e flijimit të zhdukjes së tyre. Tani e tutje, në çdo kohë e çdo ditë, do të mund të jenë me historinë dhe dhimbjen tonë përmes muzeut të masakrës. Me një fjalë, të zhdukurit dhe të vrarët, tashmë nuk i kemi vetëm horizontalisht, siç thotë kryetari ynë, por edhe vertikalisht. Ne që kemi mall, na bën të ndihemi sikur jemi me ta. Nuk e lëshoj dot këtë rast, siç e thashë në fillim, se si ndihet në krushjan kur përmallohet dhe pikëllohet një ditë kur nuk është vetëm 26 marsi. Hyrja në muze, emri i parë që reflekton është i të madhit Ukshin Hoti. Deri në arrestimin e bacës Ukë, unë isha pothuajse çdo ditë me të, ai ka 30 vjet që na mungon. Sapo hyj në muze, përballem e flas me të. Ai edhe pse duhet të ishte i dëshpëruar me ne që ende nuk bëmë asgjë për zbardhjen e fatit të tij, mua më duket sikur nuk i ka mbetur hatri shumë. Andaj unë flas e çmallem me të, sikur të ishte me mua

fizikisht. Para 26 vjetëve, unë Sefa, kur dilja nga shtëpia, muhabetin dhe kafen e parë e pija me dëshmorin, profesor Muhamet Malësorin dhe martirin Haxhi Zenuni, që edhe i kisha fqinj. Ata i takoj tani në muze me fotot e tyre të buzëqeshura dhe kur i shoh, më duket sikur të isha me ta fizikisht. Pa ecur shumë në muze, këmbët e mia prekin djepin në të cilin u rrit nipi im, dëshmori Sinan Hoti. Dua ta shoh akoma si fëmijë në djep, por kur e ngre kokën lart, e shoh të veshur me uniformë të UÇK-së, sikur më thotë: "dajë, unë nuk jam më fëmijë, jam çlirimtar dhe luftëtar lirie" dhe unë mezi marr forcë dhe ia kthej: "ti ke lindur çlirimtar, o trim". Në muze, takohem e flas me pedagogët, miqtë dhe arsimtarët e mi, Osman Ramadanin, Gani e Xhelë Nallin, me të cilët flas jo vetëm për shkollë, por për muzikë, art e sport. Aty takoj anëtarët dhe udhëheqësit e ansamblit tim "Bajram Curri" dhe K.F. "Bashkimi", me të cilët isha prej moshës 12 vjeçe. Më tutje gjej mikun tim, Fahredinin, dhe përmes fotos dhe xhaketës së tij. Doktorin e kemi që 25 vjet horizontalisht në varreza, por tani qëndron edhe vertikalisht. Më mjafton që ta shoh me sy foton e tij dhe dhimbjet e mia pushojnë sikur ta kisha fizikisht pranë. Kojshitë e mi, derisa i shoh në mur të pikëllimit, bacës Selajdin nuk kaloj dot pa i thënë me vete "toka e Krushës dhe e Kosovës po qan për ju". Ai më duket ma kthen " ne me djersën tonë mbajtëm gjallë Kosovën e varfër, duke ndihmuar dhe ushqyer – me paratë e fituara mbajtëm shkollën shqipe dhe ndihmuam UÇK-në, por ja që tokës sonë nuk i mjaftoi vetëm djersa, andaj i falëm edhe gjakun tonë". Akoma pa u larguar nga kushërinjtë, më del para Baca Xhavit – mekaniku i fshatit siç e quanin. Fillimisht më vjen pak turp ta shoh në sy, sepse hiç më pak se një muaj para se të zhduket nga serbët, e riparoi veturën time dhe nuk pranoi të marrë asnjë "cent" nga unë, duke më thënë: "hajt o Sefë, po çfarë pare, në luftë jemi – ti më shumë po rri në shtab sesa në shtëpi, andaj veturën s'e ke për biznes, por për aktivitete". I premtova një darkë Bacës Xhavit, premtimin nuk e mbajta! Iki nga fotografitë dhe kthehem te artefaktet, sendet e para që i shoh është kuleta e Bacës Ismet. A e njeh? Më pyeti dikush që kisha pranë. Po, si nuk e njoh! Sa e sa herë është hapur kjo kuletë para syve të mi. Fillimisht kur isha fëmijë, më jepte para për "bonbona". Por edhe kur u rritëm dhe mblidhnim para për shkollë dhe për UÇK-në, ajo ishte kuleta e parë që hapej. Deri sa iki nga muzeu, nga fotot dhe vizatimet në fleta, ishte Xha Mon, profesori i artit – Osman Sejfullahu. Ai bashkë me axhën tjetër, axhën Qamil, më flasin përmes fotove, sepse ata nuk kanë varre dhe akoma rezultojnë të zhdukur. Pranë tyre është edhe Bedriu, djali i axhës, me të cilin isha në gjeneratë dhe thurnim fjalë për të ardhmen, kurse tani as eshtrat nuk mund t'ia gjejmë. Sot e vizitova muzeun dhe fola me këta që i përmenda, një ditë tjetër me të tjerët dhe kështu me radhë... Ju falënderoj të gjithëve! Gjithsesi, të nderuar profesorë, studentë, ju kërkoj që akoma të jini me ne, sepse muzeu ka nevojë akoma për ju! Idetë e juaja na bëjnë dhimbjen më të lehtë dhe që vizitorëve t'u tregohet se sa i shtrenjtë ishte çmimi i lirisë.

**Selami Hoti:** Mirëdita të gjithëve! Pas të gjithë asaj që u tha, nuk më ngelet shumë të flas. Publikisht dua t'ju falënderoj të gjithëve, duke filluar nga kryetari dhe të tjerët. Kanë kaluar 25 vjet, vuajtje, ankth, dhimbje. Të gjithë që keni kontribuar që të jetësohet ky muze dhe nga mbarë bota të vinë dhe ta shohin gjenocidin. Fatkeqësisht bëmë një muze dhe jo një fabrikë. Ky muze nuk do të lejojë që *shkijet* të fabrikojnë tutje gënjeshtra kundër luftës së pastër të UÇK-së. Kinse intervenimi i tyre ishte kundër terroristëve, e këta terroristë ishin fëmijë, gra, pleq, njerëz me aftësi të kufizuara, të sëmurë në spitale e të burgosur nëpër burgjet e Kosovës dhe të ashtuquajtur Serbi, e cila akoma sulmon për të mbrojtur tokat e okupuara në Bosne, Vojvodinë dhe Sanxhak. Fatkeqësisht, akoma i kemi mbi 100 të zhdukur në Komunën e Rahovecit, e vetëm në Krushë-64. Ky muze është mision që e vërteta mos të harrohet, një mision që e vërteta të dalë në pah dhe që gjeneratat e reja, të frymëzuar nga muzeu dhe historia, të ndërtojnë fabrika dhe ta zhvillojnë vendin tutje. Të gjithëve ju falënderoj veç e veç në emrin tim personal, të familjes time të cilën ndoshta shpeshherë e kam lënë keq, për të qenë me të tjerët, secilit krushjan që ishte me ne! Gjithsesi, historia flet vetë!

**Defrim Kafexhiu:** Falminderit, kryesues! Kryetar, të nderuar profesorë, mysafirë, studiues, kolegë! Të gjithë ju që keni kontribuar për këtë vepër madhore, për të cilën sot po e marrim vendimin formal si Asamble Komunale. Ndihemi krenarë që sot, një çerekshekulli pas luftës, po e përkujtojmë këtë vend dhe në bazë të këtij kujtimi do të bëjmë hapa të kujdesshëm përpara. Faktimi i luftës na bën më të vëmendshëm, më atdhedashës dhe na bën secilin që të kemi ndërgjegje për vendin tonë dhe për punën tonë në përditshmëri. Për këtë muze duhet të ndihemi krenarë dhe secili nxënës i të gjitha shkollave duhet të ketë vend për vizitë dhe për t'i parë faktet dhe prej sot, kjo vepër

madhore do t'i plasojë faktet e krimeve serbe. Nuk ka vepër më të mirë se kjo që po e bëjmë sot. Kjo u hap rrugë edhe vendeve të tjera dhe do të merremi si shembull për t'i faktuar edhe masakrat e tjera që kanë ndodhur në Kosovë. Lavdi për të gjithë ata që kanë rënë në luftën e lavdishme për çlirimin e vendit!

**Hasan Përboqi:** Faleminderit, kryesues! I nderuari kryetar, kolegë! I nderuari z. Gajraku, z. Canolli, z. Latifi, profesionistë të fushës, z. Selami Hoti, banorë të Krushës. Më lejoni që në emër të grupit të Aleancës, ta përshëndes miratimin formal të pikës që ka për qëllim themelimin e Muzeut të Masakrës në Krushë të Madhe dhe njëkohësisht i falënderoj të gjithë ata që dhanë kontribut për ndërtimin, apo edhe ne si Kuvend për themelimin. Qëllimi është sa madhor aq edhe fisnik, sepse vetëm kështu e çojmë përpara dokumentimin e masakrës gjenocidale nga serbët ndaj popullit të pafajshëm të Krushës së Madhe. Falënderime të panumërta për të gjithë ata që punuan që të jetësohet ky muze, si për Krushën e Madhe, për Komunën dhe për të gjithë Kosovën. Falënderoj të gjithë profesorët, kryetarin, kryesuesin! Kryesuesi është djalë i një martiri të vrarë nga forcat gjenocidale serbe, në masakrën që po e përkujtojmë çdo vit. Kryesuesi, si një djalë i Krushës, e ka dhënë kontributin e tij në jetësimin e këtij muzeu. Si grup i Aleancës, shprehim mbështetje të plotë për miratimin e këtij vendimi. Nga sot, gjeneratat e reja që nuk e kanë përjetuar luftën, sado pak do të mund të shohin se çka kanë përjetuar paraardhësit e tyre nga pushtuesi gjenocidal serb.

**Burim Krasniqi:** Faleminderit, kryesues! Besoj që është e paarsyeshme të diskutojmë çështjen e votimit, ose të mosvotimit të një ngjarjeje të tillë. Është diçka shumë e rëndësishme, e domosdoshme dhe jetike për ecjen e Kosovës tutje, sikur të jenë gjallë për brezat që vinë. Më lejoni t'i falënderoj drejtuesit, Ministrinë e Kulturës, Komunën e Rahovecit dhe të gjithë ata që kontribuan në ndërtimin e objektit. Është një vepër e mirë kur shihet me sy. Objekti mbetet si objekt, pa kontributin e profesorëve që bën të kompletohet me veprat që janë brenda. Në emër të LDK-së, faleminderit, profesor Canolli, drejtor Gajraku, profesor Latifi, zonja Redona Berisha dhe Çlirimtare Jonuzaj. Falënderoj edhe Ambasadën Amerikane për kontributin! Ne bëjmë objekte të bukura, por historia përcillet me materialet që janë brenda. Ne mund të marrim vendime, por janë shumë pak në krahasim me kontributin që e keni dhënë ju dhe stafi juaj. Janë 25 gjenerata nga përfundimi i luftës dhe gradualisht diçka që nuk faktohet, fillon edhe të harrohet. Gjithmonë thuhet që një histori që harrohet, mund të përsëritet. Ky muze është një pikë referuese që ta kujtojmë të kaluarën tonë, jo në qëllim të hakmarrjes, por në qëllim të asaj se çfarë çmimi kemi paguar për çlirimin e Kosovës. Uroj që kjo pikë referuese të vizitohet nga shumë nxënës të shkollave tona dhe mbarë Kosovës. Kryetar, besoj plotësisht që sa herë që keni delegacione do t'i dërgosh në këtë muze. I bëj apel qeverisë që është sot dhe cilësdo që është nesër, që sa herë të kenë delegacione të huaja dhe bisedime për Kosovën, le të vijnë paraprakisht për vizitë në Muzeun e Krushës së Madhe dhe do të jenë të ndërgjegjshëm për hapat, veprimet dhe vendimet që do të merren.

**Bejtullah Deliu:** Faleminderit, i nderuari kryesues! Kryetar, profesorë të nderuar, kryetar Hoti, kolegë asambleistë. Komuna e Rahovecit është vetë muze. Si arrite në bjeshkët e Zatriqit e deri te Krusha e Madhe, secila rrugë është sikur damarët e njeriut që tregojnë kalimin e historisë, gjatë, para dhe pas lufte. Po erdhe nga Opterusha e deri në dalje te Guri i Kuq, gjithashtu janë rrugë që të çojnë në muze. Themelimi i një objekti në Krushë të Madhe, tregon një bazament të fort të faktuar për mbarë botën. Më shumë për këtë muze kanë biseduar profesorët që i thanë fjalët e tyre dhe besoj që jam shumë jokompetent të flas për atë muze. Unë i përkas një subjekti politik që e ka bazamentin edhe te liria, edhe te çlirimi, por edhe te ruajtja dhe kontributi i madh për kohën dhe vendin, ku jemi dhe ku ishim. Kemi punuar mjaft, kemi mbledhur fakte, por nuk duhet të ndalemi që gjeneratë pas gjenerate t'i shohin dhe të ballafaqohen me këto argumente.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë, Bejtullah Deliu! A ka edhe dikush diçka tjetër në lidhje me këtë çështje?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim pikën e dymbëdhjetë! Kush është "për"?... Konstatoj që unanimisht (29) votohet vendimi për themelimin e Muzeut të Masakrës në Krushë të Madhe. Ftoj kryetarin Smajl Latifi, që t'u shpërndajë mirënjohje atyre që kontribuan në themelimin e muzeut.

**Blerta Nalli Gashi:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Fillimisht, kërkoj falje për emocionet, që në një ditë si kjo janë mëse normale. Komuna e Rahovecit në shenjë falënderimi dhe përkushtimi, ndan mirënjohje për:

**Prof. Asoc. Dr. Arsim Canolli,** Departamenti i Antropologjisë, Universiteti i Prishtinës.
Motivacioni: **për kontributin vullnetar (nëntor 2023 - mars 2024) si kurator dhe udhëheqës në konceptimin, dizajnimin dhe përgatitjen e ekspozitës muzeale të Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe.**
**Prof. Asoc. Dr. Florina Jerliu,** Fakulteti i Arkitekturës, Universiteti i Prishtinës.
Motivacioni: **për kontributin vullnetar (nëntor 2023 - mars 2024) si kuratore dhe udhëheqëse në konceptimin, dizajnimin dhe përgatitjen e ekspozitës muzeale të Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe.**
**Prof. Ass. Dr. Tahir Latifi,** Departamenti i Antropologjisë, Universiteti i Prishtinës,
Motivacioni: **për kontributin vullnetar (nëntor 2023 - mars 2024) si kurator dhe udhëheqës në konceptimin, dizajnimin dhe përgatitjen e ekspozitës muzeale të Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe.**
**Prof. Ass. Dr. Kaltrina Thaçi,** Fakulteti i Arkitekturës, Universiteti i Prishtinës,
Motivacioni: **për kontributin vullnetar në punëtorinë treditore (25 - 27 janar 2024) për dizajnimin konceptual të Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe.**
**Prof. Ass. Dr. Ardita Byci Jakupi,** Fakulteti i Arkitekturës, Universiteti i Prishtinës,
Motivacioni: **për kontributin vullnetar në punëtorinë treditore (25 - 27 janar 2024) për dizajnimin konceptual të Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe.**
**Ass. Denis Dalladaku,** Fakulteti i Arkitekturës, Universiteti i Prishtinës,
Motivacioni: **për kontributin vullnetar në punëtorinë treditore (25 - 27 janar 2024) për dizajnimin konceptual të Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe.**
**Znj. Tringa Sefedini,** studente në Departamentin e Antropologjisë, Universiteti i Prishtinës
Motivacioni: **për kontributin vullnetar në dizajnimin dhe përgatitjen e ekspozitës muzeale të Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe.**
**Znj. Çlirimtare Januzaj,** e diplomuar në Departamentin e Antropologjisë, Universiteti i Prishtinës,
Motivacioni: **për kontributin vullnetar në dizajnimin dhe përgatitjen e ekspozitës muzeale të Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe**
**Znj. Flaka Berisha,** master në Departamentin e Sociologjisë, Universiteti i Prishtinës,
Motivacioni: **për kontributin vullnetar në dizajnimin dhe përgatitjen e ekspozitës muzeale të Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe.**
**Znj. Ridona Berisha,** master në Departamentin e Sociologjisë, Universiteti i Prishtinës,
Motivacioni: **për kontributin vullnetar në dizajnimin dhe përgatitjen e ekspozitës muzeale të Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe.**
**Znj. Valentina Krasniqi,** e diplomuar në Departamentin e Antropologjisë,
Motivacioni: **për kontributin vullnetar në dizajnimin dhe përgatitjen e ekspozitës muzeale të Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe.**
**Z. Ari Nekoviqi,** student në Fakultetin e Arkitekturës, Universiteti i Prishtinës,
Motivacioni: **për kontributin vullnetar në dizajnimin dhe përgatitjen e ekspozitës muzeale të Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe.**
**Znj. Eurta Salihaj,** studente në Fakultetin e Arkitekturës, Universiteti i Prishtinës
Motivacioni: **për kontributin vullnetar në dizajnimin dhe përgatitjen e ekspozitës muzeale të Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe.**
**Z. Ylljan Kurti,** student në Fakultetin e Arkitekturës, Universiteti i Prishtinës,
Motivacioni: **për kontributin vullnetar në dizajnimin dhe përgatitjen e ekspozitës muzeale të Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe.**
**Z. Alban Markaj,** student në Fakultetin e Arkitekturës, Universiteti i Prishtinës,
Motivacioni: **për kontributin vullnetar në dizajnimin dhe përgatitjen e ekspozitës muzeale të Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe.**
**Znj. Drenushë Behluli-Mehmeti,** Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,

Motivacioni: **për kontributin vullnetar në punëtorinë treditore (25 - 27 janar 2024) për dizajnimin konceptual të Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe.**
**Z. Fazli Gajraku,** Biblioteka Kombëtare e Kosovës
Motivacioni: **për kontributin vullnetar në punëtorinë treditore (25-27 janar 2024) për dizajnimin konceptual të Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe**
**Z. Samir Hoxha,** Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, Prizren,
Motivacioni: **për kontributin vullnetar në punëtorinë treditore (25 - 27 janar 2024) për dizajnimin konceptual të Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe.**
**Z. Sali Shohi,** ChWB,
Motivacioni: **për kontributin vullnetar në punëtorinë treditore (25-27 janar 2024) për dizajnimin konceptual të Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe.**
**Kryesuesi:** Falënderojmë Kryetarin Smajl Latifi për mirënjohjet dhe të gjithë ata që kontribuan për realizimin e këtij objekti madhor, Muzeun e Masakrës – Krushë e Madhe! Shihemi në mbledhjet e radhës!

**Procesmbajtësi:** | **K R Y E S U E S I**

______________

**Albion Krasniqi**

______________

**Arbër Zenuni**

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008")*, nenit 253 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 57/2009")*, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016")*, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2024 merr këtë:

## VENDIM
### Për konstituimin e të drejtës së kalimit (servitutit sendor)

**1.** Me këtë vendim miratohet kërkesa e qytetarëve të Lagjes Krajishtë për konstituimin e të drejtës së servitutit sendor (të drejtës së kalimit) në parcelat publike kadastrale sipas certifikatave të pronësisë si në vijim:

**1.1.** Parcela sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-02680-1 në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur krajishta, me kulturë kullosë e klasës 5, në posedim të Komuna e Rahovecit, në sipërfaqe të përgjithshme prej 5259m$^2$ (pesëmijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntë metra katrorë) nga e cila ndahet sipërfaqja prej 116 m$^2$ (njëqind e gjashtëmbëdhjetë metra katror).

**1.2.** Parcela sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-02680-2 në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur krajishta, me kulturë kullosë e klasës 5, në posedim të Komuna e Rahovecit, në sipërfaqe të përgjithshme prej 1235m$^2$ (njëmijë e dyqind e tridhjet e pesë metra katrorë), nga e cila ndahet sipërfaqja prej 367m$^2$ (treqind e gjashtëdhjetë e shtatë metra katror).

**2.** E drejta e kalimit në pjesët e parcelave kadastrale të cekura në nenin 1 të këtij vendimi ka gjerësinë 4 (katër) metra, në jug-perëndim gjatësinë e përgjithshme prej 122.03 (njëqind e njëzet e dy pikë zero tre) metra dhe në lindje-jug gjatësinë e përgjithshme prej 121.36 (njëqind e njëzet e një pikë tridhjet e gjashtë) metra.

**3.** Krijimi i të drejtës së kalimit në pjesët e parcelave kadastrale të cekura në nenin 1 dhe 2 të këtij vendimi i dedikohet banorëve të Lagjes Krajishtë, të cilët janë posedues të pronave private e të cilët nuk kanë qasje në rrugën publike dhe si bartës të të drejtës së kalimit sipas këtij vendimi do të kenë mbrojtjen e të drejtës së autorizuar dhe në kohë të pacaktuar për shfrytëzimin e të drejtës së kalimit, respektivisht rrugës si e mirë publike, e cila rrjedh nga e drejta e pronësisë në paluajtshmërinë shërbyese të tokës komunale, me kusht që ndërtimin dhe meremetimin e kësaj rruge ta kryejnë me shpenzimet e veta.

**4.** Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që sipas detyrës zyrtare të bëjë regjistrimin e pronës në librat kadastral.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.

6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**K U V E N D I   I   K O M U N Ë S   N Ë   R A H O V E C**

**01-Nr.____/24**
**Me datë:00.05.2024**

**Arbër Zenuni**

______________

**Kryesues i Kuvendit**

Kuvendi i Komunës së Rahovecit, duke vendosur sipas kërkesës së grupit të qytetarëve të Lagjes "Krajisht", të cilët i përfaqëson Hysn Mahmut Hamza, nga Rahoveci, në çështjen administrative-konstituimi i të drejtës së servitutit në pronësinë komunale, në bazë të nenit 17, 43 dhe 52 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040 , nenit 253 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore nr. 03/L-154, nenit 13 dhe 84 të Ligjit mbi procedurën administrative nr. 02/L-28 dhe nenit 5 dhe 36 të Statutit të Komunës së Rahovecit, merr

